

Qytetërimi Islam

Sami Frashëri



0 [Q Y T E T E R I M I I S L A M]

[Q Y T E R I M I S L A M I]

QYTETËRIMI ISLAM

Sami Frashëri

© LOGOS - A

2 0 0 9



S H K U P

P R I S H T I N Ë

T I R A N Ë

Sami Frashëri
QYTETËRIMI ISLAM

Boton: Logos-A
Biblioteka: Mendimi Islam

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi
Redaktor teknik: Afrim Gashi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus - Shkup

Copyright©Logos-A, 2009

Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet në
Bibliotekën Kombëtare Universitare
ISBN 9989-58-291-2

www.logos-a.com.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe
jositimprurës.
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit
apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi
pa lejen paraprake të Logos-A.

QYTETËRIMI ISLAM

Sami Frashëri



4 [Q Y T E T E R I M I I S L A M]

*Prindërve të mi
Nazmije dhe Dilaver ef Polisi
dhe mixhës tim Sali Polisi.*

Përbajtja:

Sami Frashëri në fushën e Islamistikës 7

Qytetërimi islam 19

Astronomia 39

Shkencat matematikore 68

Gjeografia 72

Shkencat natyrore 78

Mjekësia 81

Filozofia 86

Ligji 89

Letërsia 91

Historia 97

Mjeshtëritë dhe zbulimet gjeografike 104

Disa zbulime 108

Përfundim 109

6 [Q Y T E T E R I M I I S L A M]

Sami Frashëri në fushën e Islamistikës

Është shkruar sa e sa herë se Sami Frashëri, ky dijetar i madh shqiptar, i njohur në shkallë ndërkombëtare, shkroi shumë vepra (mbi gjashtëdhjetë) në shumë fusha e në shumë gjuhë: shqip, turqisht, arabisht, persisht, frëngjisht, greqisht etj.

Sipas një llogaritjeje duke u mbështetur në monografitë e shkruara për të,¹ (disa vepra kryesore të tij i kemi edhe ne) del se Samiu ka shkruar rreth 20 mijë faqe, duke mos i llogaritur këtu disa vepra të pabotuara dhe artikujt e shumtë të botuar nëpër gazeta e revista të ndryshme të kohës. Ky numër është i madh, do të thoshim shumë i madh, po të mbajmë parasysh se vepra e tij është e thellë dhe e gjithanshme. Sa për ilustrim, po përmendim enciklopedinë e tij *Kāmūs-al-a'lām*,² në gjashtë vëllime me 4830 faqe të formatit të madh (17/25 cm.), e shkruar shumë ngjeshur, që përfshin mijëra njësi të veçanta historike dhe gjeografike me karakteristika të hollësishme, shumë prej të cilave s'i gjen dot nëpër enciklopedi të tjera, pastaj, të personaliteteve botërore të fushave të ndyshme nga të gjitha kohët. Secila nga këto njësi, ndryshe nga të

¹ A. S. Levend, *Şemsettin Sami*, Ankara, 1969; Z.H. Bakiu, *Sami Frashëri, Vepra 8*, Prishtinë, 1984; H. Kaleshi, *Sami Frashëri në letërsinë dhe filozofinë turke*, Gjurmime albanologjike 1, 1968, Prishtinë.

² Më gjerësisht shih Sami Frashëri, *Vepra 9, Personalitetet shqiptare në Kamūs-al-a'lām*, zgjodhi, përktheu dhe shpjegoi Mehdi Polisi, Shkup, 1994.

shkruarit romane, nëse mund të shprehemi kështu, patjetër kërkon kohë dhe hulumtime të veçanta. Kështu do gjykuar natyrisht edhe për veprat e tjera të tij. Kjo është njëra anë e veprimitarisë së tij, domethënë, ana sasiore, vëllimore. Është edhe ana tjetër, më kryesorja, më e rëndësishmja, ajo cilësorja. *Kāmūs-al-a'lāmin*, këtë vepër madhore të enciklopedisë historike dhe gjeografike; pastaj fjalorët e tij të shumtë njëgjuhësh dhe dygjuhësh³ etj., për shkak të vlerave të tyre, kanë nevojë t'i mbajnë në tavolinat e tyre të punës edhe sot e gjithë ditën shkencëtarë të fushave përkatëse: historianë, gjeografë, filologë, leksikografë, letrarë, islamologë, orientalistë etj. Idetë dhe pikëpamjet patriotike të Samiut, të shtruara që në tridhjetë vjetët e fundit të shek. 19, mbeten gjithnjë aktuale edhe pas njëqind e sa vjetësh. Për shembull, vepra e tij "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?"⁴, që përmban programin e krijimit të shtetit shqiptar (jo në kufijtë aktualë), e shkruar nga Samiu dhe e botuar për të parën herë në Bukuresht më 1899, d.m.th. para më shumë se njëqind vjetësh, për shkak të karakterit dhe përbajtjes së saj, në rrethana të ndryshme shoqërore, pati batica dhe zbatica, rënie e ngritje, por në ditët e sotme, bëhet edhe më aktuale, më e fuqishme.

Duke pasur parasysh veprimitarinë e tërësishme të tij, që as për së afërmi nuk u përmend këtu, pra, po ta bashkojmë anën sasiore dhe cilësore të veprës së tij,

³ Samiu ka hartuar pesë fjalorë: *Turqisht-frëngjisht; Frëngjisht-turqisht; Fjalori i vogël i turqishtes; Arabisht-turqisht; Fjalori i gjuhës turke*, shih më gjérësisht te monografitë e cituara.

⁴ Shih *Sami Frashëri, Vepra 2*, Prishtinë, 1978.

nuk gabohet kur Samiut i jepen cilësime të ndryshme: shkencëtar, mendimtar, leksikograf, filolog, letrar, publicist, patriot etj., shkurt, erudit dhe ideolog.

Krahas veprave të mëdha e të rëndësishme, Sami Frashëri i kishte shtruar vetes edhe një detyrë shumë të rëndësishme: të shkruante edhe në fushë të islamistikës. Ndërsa në fusha të tjera të shkencës Samiu është studiuar më tepër, në fushën e islamistikës është përmendur më pak,⁵ madje edhe kur përmendet në këtë fushë, qëllimi ose për mosdije, është keqinterpretuar.⁶

Në fushën e islamistikës Samiu shkroi dy vepra: *Medeniyyet-i İslamiyye* ("Qytetërimi islam") dhe *Himmetu-l-Himām fi neshri-l-Islām* ("Përpjekja e heronjeve në përhapjen e Islamit").

Vepra *Qytetërimi islam* mban numrin 1 të serisë "Biblioteka e xhepit" (Cep Kütüphanesi)⁷: është botuar në shtypshkronjën "Mihran" në Stamboll më 1296/1879 (bot. i parë) me 126 faqe⁸, dhe më 1302/1885 (bot. i dytë). Siç shihet nga titulli, është shkruar në gjuhën turke-osmane. Është e ndarë në 35 kapituj të shkurtër; nuk ka parathënie; kapitujt 1–7 mbajnë titullin e librit, kurse kapitujt e tjerë titullohen sipas

⁵ Shih për këtë H. Kaleshi, pun. i cit. f. 85.

⁶ Nga vepra e tij, si në gjuhën shqipe, si në gjuhën turke, arabe etj., nuk del që Samiu të ketë kritikuar ndonjëherë parimet thelbësore dhe të drejta të Fesë Islame, të Kur'anit. Në qoftë se ka kritikuar diçka në këtë fushë, ai ka kritikuar keqinterpretuesit dhe keqpërdoruesit e Islamit.

⁷ Serinë Cep Kütüphanesi e themeloi Mihrani, botuesi i shumicës së veprave të Samiut, më 1879. Përfshin 32 vepra, prej të cilave 15 ishin të Samiut.

⁸ Edhe Bakiu (sh. Vep. e cit.); edhe Kaleshi (sh. pun. e cit.) e shënojnë gabisimisht 123 faqe.

fushave shkencore: astronomi, shkencat matematikore, gjeografi, shkencat natyrore, mjekësi etj.

Veprën *Qytetërimi islam* e kemi përkthyer në gjuhën shqipe të plotë, pa përdorur, siç do të thoshte prof. Rexhep Ismajli, trepikësha, sepse vetëm kështu mund të shihen dhe të kuptohen drejt pikëpamjet e Samiut në cilëndo fushë qofshin, pra edhe në fushën e islamistikës. Është kjo vepra e parë e plotë, e tërësishme, përbajtësore në gjuhën shqipe për qytetërimin islam. Sado që nuk është dhe aq e vëllimshme, ka vlerë të lartë dhe ngërthen një material të konsiderueshëm, sepse Samiu, falë njojurive dhe mjeshtërisë së tij enciklopedike, diti që një temë shumë të gjerë ta përfshinte e ta përmblidhte në një libër të vogël, duke mos lënë pa përmendur thuajse asgjë të rëndësishme.

I mbrujtur me kulturën e gjërë të qytetërimit islam, nga njëra anë, dhe të qytetërimeve të tjera, nga ana tjetër, Samiu në këtë vepër shtron shumë çështje interesante. Meqenëse vepra "*Qytetërimi islam*" tanë është në duart e lexuesit shqiptar, nuk do të doja të thellohesha në komentime të hollësishme të ideve e pikëpamjeve të Samiut në këtë fushë, pikërisht sepse lexuesi do ta lexojë veprën dhe do të gjykojë vetë për to. Megjithatë, vlenë të përmenden disa theksime të tij.

Në fillim të veprës Samiu jep shpjegime të mjaf-tueshme dhe të arsyeshme rrëth dallimit të njeriut nga kafshët dhe dallimit të njerëzve midis tyre. Njeriu, thotë Samiu, ka diçka që s'e ka askush: *mendjen* dhe *inteligjencën*. Me këto elemente ai e dallon njeriun nga kafshët. Kurse ndryshimet mes njerëzve nuk i sheh në fizionomi, në ngjyrën e lëkurës e në veshm-

bathje, veçse në fuqinë mendore, në njohuritë dhe në dituritë shkencore, pra në qytetërimin. Për Samiun thelbi i qytetërimit dhe masa e zhvillimit të tij është dituria. Për të arritur një shkallë të lartë të qytetërimit, sipas tij, njeriu duhet ta vëré në shërbim mendjen, të përpinqet vazhdimi i punojë, të mësojë e të zbulojë të vërtetën dhe gjëra të reja të dobishme, të cilat do t'i mundësojnë e do t'i sigurojnë mirëqenien e tij dhe të njerëzimit në përgjithësi.

Pas këtyre përgjithësimeve, Samiu hyn në thelbin e problemit. Me fryshtë polemizuese u përgjigjet shumë pyetjeve që qarkullonin në kohën e tij: *Ç'është qytetërimi islam, fryt dhe rezultat i çkaje është? A mund të quhet "qytetërimi islam" "qytetërim arab"? Si dhe sa ka ndikuar qytetërimi islam në qytetërimin evropian, përkatesisht, sa e ka ndihmuar qytetërimi islam qytetërimin evropian? A është i kufizuar qytetërimi islam vetëm tek një popull a tek një bashkësi? Në ç'mënyrë u përhap qytetërimi islam? Kush e ka ndihmuar përhapjen e qytetërimit islam dhe ku e ka mbështetjen ai? etj.* Të gjitha këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave, që nuk i përmendëm këtu, Samiu u përgjigjet qartë dhe në mënyrë të argumentuar. Po japim shkurtazi disa prej tyre:

Tezën e një grupei të dijetarëve evropianë që njëjtësonin "qytetërimin islam" me "qytetërimin arab", Samiu e hedh poshtë kategorikisht. Këtë e argumenton me faktin se qytetërimi islam është fryt i Fesë islamë dhe është paraqitur bashkë me shfaqjen e Islamit dhe nuk është prodhim mendor dhe përpjekje e popullit arab, sepse po të ishte ashtu, arabët edhe para Islamit, thotë Samiu, do të duhej ta kishin po atë

qytetërim. Njëkohësisht në përparimin e qytetërimit islam marrin pjesë të gjithë popujt që e kanë përqafuar Islamin. Ata që dëshirojnë ta quajnë qytetërimin islam qytetërim arab -, vazhdon Samiu, - harrojnë se shumica e dijetarëve që i mbajnë për dijetarë arabë, janë joarabë, p.sh. Ibn Sinai është persian, Farabi është turk, Salahuddin Ejubi, kurd etj. Samiu këtu del fitues, sepse teza e tij më vonë pranohet nga pjesa dërrmuese e dijetarëve realistë e objektivë evropianë.

Samiu i kundërvihet vendosmërisht edhe një grupei të dijetarëve evropianë, të cilët mendonin se qytetërimi evropian kishte lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi i lashtë grek. Sipas Samiut, edhe qytetërimi i lashtë grek, ashtu si qytetërimet e tjera të lashta të halleasve, asirasve, midiasve, fenikasve etj., është ndërprerë për një kohë, prandaj periudha kohore 8-10 shekullore, nga ndërprerja e qytetërimit grek e deri në zgjimin e ngritjen e qytetërimit evropian, nuk mund të ishte pa qytetërim; nuk mund të besohet që çdo anë e rruzullit tokësor të ketë qenë e fundosur në errësirë e në injorancë. Po t'u qasemi me vëmendje rr Ethanave dhe historive të këtyre shekujve, si dhe shumë veprave në të cilat flitet për qytetërimin, do të kuptojmë se në këta shekuj kishte një qytetërim të plotë dhe më të përsosur se të mëparshmit, që ishte qytetërimi islam, do të thotë Samiu. Këtë të vërtetë, vazhdon Samiu, e pranuan dijetarët objektivë e realistë evropianë duke u mbështetur te veprat e përkthyera të qytetërimit islam në gjuhën latine, e cila asokohe ishte gjuhë shkencore e përgjithshme e evropianëve. Evropianët, pra, dëgjuan dhe mësuan për herë të parë për dijeta-

rët antikë grekë, - për Platonin, Aristotelin, Ptoleme-un, Euklidin etj., nga veprat e tyre të përkthyera në gjuhën arabe nga dijetarë islamë. Kjo, thotë Samiu, është një e vërtetë që është dëshmuar sot me anë të historisë dhe për këtë nuk mund të ketë ndonjë kundërshtim, dyshim a luhatje.

Qytetërimi islam, ndryshe nga qytetërimet e tjera, ka disa karakteristika të veçanta. Ai, thotë Samiu, nuk është ndërprerë asnjëherë, ndonëse gjithnjë ka pasur prirje dhe përpjekje të tilla nga misionarë të ndryshëm; nuk është i kufizuar dhe i veçantë vetëm tek një popull a bashkësi dhe, e treta, ai u përhap menjëherë me lehtësi të madhe, pra duke mos kundërshtuar, duke mos sakrifikuar jetë dhe duke mos krijuar vësh-tirësi e fatkeqësi, sepse mbështetet, vazhdon Samiu, pikërisht në Fenë islame, në mësimet e Kur'anit, i cili urdhëron kërkimin e diturisë, të shkencës e të së vërtetës dhe është udhërrëfyes i qytetërimit, i drejtësisë dhe i zbatimit të saj; në shembullin e Pejgamberit a.s. i cili në mënyrë urdhëruese thotë: "*Kërkoni diturinë nga djepi deri në varr*" dhe "*Kërkoni diturinë qoftë dhe në Kinë*" (sh. kap. 4 -7).

Për të treguar shkallën e qytetërimit islam në 8-9 shekujt e parë nga paraqitja e Islamit, Samiu, në vazhdim të veprës, nga kapitulli 8 e tutje, bën fjalë për arritjet shkencore të myslimanëve në fusha të ndyshme shkencore: në astronomi e astrologji, në shkencat matematikore, në gjeografi, në shkencat natyrore, në mjekësi, në filozofi, në jurisprudencë, në letërsi, në mjeshtëri dhe në zbulime të tjera. Këtu Samiu përmend me qindra emra që kanë dhënë kontributin e

tyre në përparimin e disiplinave shkencore, sa duke shkruar vetë libra, aq duke përkthyer librat e dijetarëve antikë grekë, indianë, persianë etj., duke shpikur vegla e mjete të ndryshme që u shërbenin në punën e tyre shkencore në praktikë. Për shumë shpikje e zbulime shkencore, Samiu thotë se dijetarët islamë janë të parët autorë, e për shumë të tjera thotë se i kanë përmirësuar e ndrequr ato të paraardhësve të tyre.⁹ Nuk e shohim të udhës t'i përmendim këto, sepse do të na conte larg, por ajo që na bie në sy këtu dhe që është shumë e rëndësishme të theksohet, është fakti se këta dijetarë për punën e tyre janë ndihmuar dhe nxitur veçanërisht nga udhëheqësit e tyre: kalifët, sulltanët, mbretërit islamë etj., përkatësisht nga i gjithë aparati shtetëror islam. Ata tubonin pranë vetes dijetarët më të shquar nga të gjitha anët e Botës Islame dhe të tjerë, u krijonin kushte të volitshme për punë, duke u ndihmuar në nxitjen e bibliotekave, laboratorëve, observatorëve etj., varësisht nga natyra e fushës shkencore, dhe për rezultatet e tyre i shpërbolenin me çmimet më të larta. Mjafton të përmendim vetëm Memunin, një nga kalifët e Dinastisë së Abasidëve, i cili, siç shkruan Samiu, veprat e dijetarëve i vinte në peshojë, dhe peshën e tyre e paguante me ar.

E këtillë qe Bota Islame gjatë 8-9 shekujve të parë. Ndërsa bënин gara në dituri, në shkencë, në zbulime e shpikje, ndërkohë udhëhiqeshin nga parimet e pastra islame, shkruan Samiu, - ajo përparonte në çdo anë të

⁹ Një mendim të tillë e gjen edhe sot në veprën enciklopedike me titullin *Kleine Enzyklopädie-Natur*, Leipzig, 1961. (sipas H.Z. Bakiut, vepr. e cit. f. 161/2).

botës dhe në çdo fushë të jetës njerëzore. Duke u përhapur në anë të ndryshme të botës: në Azi, në Afrikë, në Evropë, ajo shpëtoi shumë popuj nga terri dhe nga injoranca, thotë Samiu.

Pikëpamjet e veta rrëth zgjerimit të shtetit islam; mënyrën e përhapjes dhe vlerat e Fesë Islame, Samiu do t'i paraqesë ngjeshur dhe në veprën e tij *Himmetu-l-Himam fi neshri-l-Islam*. ("Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit"), shkruar në gjuhën arabe, e botuar 6 vjet pas veprës "Qytetërimi islam", që do të thotë se Samiu ka shkruar në vazhdimësi në fushën e islamistikës.

Përsa i përket mënyrës së përhapjes së Fesë islam, pas një kahasimi të thellë e të gjithanshëm në mes Islamit dhe Krishterimit, Samiu thotë se Islami ndryshe nga Krishterimi është përhapur kryesisht vetveti, pa përdorimin e forcës dhe pa përdorur misionarë e misione të organizuara, e kjo është plotësisht në përputhje me parimet e tij. Këtë e argumentonte me faktin se në shumë vende, si p.sh. në Afrikën e Ekuatorit, në Ujdheshat e Paqësorit etj., në të cilat ndonëse nuk kanë qenë asnjëherë nën juridiksionin e shtetit islam, Feja islame është shtrirë dhe shtrihet gjithnjë e më tepër.¹⁰ E, duke folur për vlerat e Islamit, Samiu pohon se paraqitja e Fesë Islame bëri kthesë të madhe në shoqërinë njerëzore. Ajo, zëvendësoi politeizmin me monoteizëm, barbarinë me qytetërimin, paditurinë

¹⁰ Rreth mënyrës së përhapjes së Islamit pa përdorimin e forcës, mund të shihet edhe vepra e Thomas Arnoldit "The Preaching of Islam", Algorh, 1896 (bot. i parë) dhe London, 1913 (bot. i dytë)". Në këtë libër në një kapitull të veçantë bëhet fjalë edhe për përhapjen e islamit ndër shqiptarë.

me dituri, urejtjen me respektin ndaj njëri-tjetrit, dembelinë me përpjekje në punë, papastërtinë me pastërti, poligaminë me monogami, shthurjen familjare me harmoni familjare, amoralitetin me moralin, egoizmin me zemërgjerësinë, nëpërkëmbjen e femrës me barazinë me mashkullin, padrejtësinë me drejtësinë etj.

Në fund të veprës "Qytetërimi islam" Samiu paralajmëronte, se do të shkruante edhe dy vepra të tjera të kësaj natyre: "Popujt Islamë, e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja", ku do të trajtonte, siç thotë ai, shkaqet dhe mënyrën e shthurjes së myslimanëve, dhe "Qytetërimi evropian", në të cilën do të shkruante se qytetërimi i tashëm evropian ka lindur nga qytetërimi islam. Mjekësht, këto dy vepra Samiu nuk ka arritur t'i shkruante, së paku sipas hartuesve të monografive të tij dhe të studiuesve të tjerë që janë marrë me Samiun. Ç'ësh-të e vërteta, Samiu edhe në veprën "Qytetërimi islam", edhe në veprën "Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit" u sillet këtyre çështjeve, e ndoshta këto pikat të ndjeshme kishte menduar t'i thellonte më tej.

Sido qoftë, edhe në veprën "Qytetërimi islam" dhe në "Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit", të cilat lirisht mund të konsiderohen manualë të qytetërimit islam në gjuhën shqipe, vihen në dukje shumë qartë faktorët e njërsës dhe faktorët e tjetrës anë.

Po ritheksojmë se pikëpamjet e Samiut për qytetërimin islam, për Islamin, për përparimin e myslimanëve gjatë 8-9 shekujve të parë, për shkaqet e rënies së tyre më pastaj etj., mund të kuptohen të plota, pasi të lexohen këto vepra në tërësi. Prej tyre mund të nxjerrrim mësime të shumta edhe ne.

Shfrytëzoj rastin të falënderoj *recensentin Prof. dr. Ismail Ahmedin* dhe redaktorin *Prof. dr. Xhevat Lloshin* për kontributin e tyre që dhanë në ngritjen e cilësisë së veprës. Falënderoj njëkohësisht edhe z. *Adnan Ismailin* që më siguroi origjinalin e veprës.

Prishtinë, 15.09.2004

Dr. Mehdi Polisi

18 [Q Y T E T E R I M I I S L A M]

Qytetërimi islam

1

Rruzulli tokësor është një pjesë e vogël nga krijet e panumërtë të Fuqisë së Zotit. Meqenëse jetojmë dhe jemi ngushtësisht të lidhur me të, interesimi ynë për rrutzullin tokësor është i njëjtë me atë për tërë gjithësinë, ndoshta edhe më i madh. Sado që rrutzulli tokësor është vendi ku jetojnë kafshë (krijesa) të panumërtë, njeriu është mbi nivelin e këtyre kafshëve, për shkak se ka mendjen dhe inteligjencën. Kështu, duke mbajtur parasysh këto tipare, vetveti kuptohet se nuk mbetet shumë vend për t'u marrë me kafshët e tjera. Pra, është e drejtë që rrutzulli tokësor të vështrohet në radhë të parë si vendbanim i botës njerëzore.

Duke gjykuar se kemi një pozitë shumë të lartë në këtë rrutzull, le ta përqendrojmë vëmendjen tek njerëzit që jetojnë në rrutzullin tokësor; t'u hedhim një sy njerëzve dhe popujve që banojnë në të gjitha anët e tij. Mes tyre do të vërejmë aq dallime, saqë, do ta kishim të vështirë t'i vështronim të gjithë njësoj, si dhe t'i dallonim nga grapi i kafshëve. Kur flas për dallimin këtu, nuk e kam fjalën te ndryshimet nga ngjyra, nga fizionomia dhe veshmbathja; dallimi në mes një zezaku dhe një të bardhi është sikurse dallimi në mes

të një njeriu me flokë të zinj dhe një njeriu me flokë të verdhë. Nuk duhen bërë dallime e ndarje të këtilla në mes të njerëzve. Dallimi dhe ndryshimi për të cilin po flas, është nga pikëpamja mendore, nga pikëpamja e njohurive dhe e shkathësive diturore. Ajo që e veçon dhe që e dallon njeriun nga kafshët e tjera, është shkalla dhe fuqia mendore. Në këtë kuadër, aq sa dallohet nga kafshët e tjera ai njeri, fuqia dhe shkalla mendore e të cilit është shumë e lartë, e jashtëzakonshme, po aq u afrohet kafshëve njeriu, fuqia dhe shkalla mendore e të cilit është shumë e ulët.

Këtë dallim dhe ndarje mes njerëzve, do ta shohim nga pikëpamja hapësinore dhe kohore, d.m.th. duke iu drejtar historisë së njerëzimit. Po të hedhim një shikim gjografik, në Francë do të shohim popuj të qytetëruar, kurse në Borneo popuj të egër, e duke i hedhur një shikim historisë, do të marrim vesh se në Francë para dy mijë vjetësh kishte popuj të egër, e tash janë të qytetëruar, kurse atëbotë, në luginën e Tigrit, kishte popuj të qytetëruar, e tash ka popuj endacakë.

Njerëzit nuk ndryshojnë midis tyre si natyrë dhe si krijesa. Ky dallim nuk është i domosdoshëm as nga pikëpamja hapësinore, as kohore. Po të ishte ky dallim i domosdoshëm nga pikëpamja hapësinore, popullsitetë në Francë do të duhej të ishin gjithmonë endacakë. Megjithatë, në Francë, ku sot jeton një popull i qytetëruar, e dimë se para dy mijë vjetësh ka pasur popuj endacakë dhe, në luginën e Tigrit, që sot është e banuar nga një popull endacak, para dy mijë vjetësh ka pasur një popull të qytetëruar. Po të ishte ky dallim i domosdoshëm nga pikëpamja kohore, do të

duhej të ishin, për shembull, të gjithë njerëzit dhe popujt para dy mijë vjetësh në një gjendje, po edhe sot të gjithë do të duhej të ishin në një gjendje. Por, edhe këtu shohim të kundërtën.

Ajo që shkaktoi dhe e solli këtë dallim midis njerëzve, është një tërësi rrëthanash karakterizuese jo të qëndrueshme, që quhet QYTETËRIM¹¹. Kur thuhet se njeriu është i qytetëruar nga natyra, dëshirohet të arrihet që qytetërimi të kthehet në cilësi të përhershme në natyrën e njeriut, por pa këmbëngulur që të pohohet si e vërtetë se njeriu vetveti është i qytetëruar dhe se është krijuar i qytetëruar. Njeriu është krijuar në një gjendje pothuajse të egër, përafërsisht si kafshët e tjera, porse atij, dhe sidomos atij i është dhënë aftësia e mundësia dhe i janë krijuar e përgatitur kushtet për qytetërimin nga ana e Zotit, që ta përmirësojë gjendjen e vet dhe të mund të qytetërohet.

Njeriu është krijuar në një gjendje të egër, por jo për të mbetur i egër. Ashtu si shumica e kafshëve që kanë një rol, edhe njerëzit ushtrojnë veprimitari dhe role të mëdha. Ashtu si bleta, që mbledh nektarin e shijshëm nga lulet dhe është e përsosur në punën e saj, në veprimtarinë dhe rolin e saj për të bërë mjaltin, po ashtu edhe njeriu, duke kuptuar thelbin dhe të vërtetën e lëndëve që ndodhen në gjithësi, dhe sidomos në rruzullin tokësor, ka për detyrë t'i zhvillojë, t'i plotësoje e t'i përsosë ato për të krijuar e për të siguruar mirëqenien dhe lumturinë e njerëzimit.

¹¹ Në artikujt shqip Samiu përdor termin "qytetëri".

Për të ruajtur e për të mbrojtur veten nga çdo kafshë, nga çdo rrezik dhe nga çdo vështirësi tjetër, ai ka me vete armë, veshjen dhe mjete të tjera. Njeriu u krijuar lakuriq dhe i zhveshur nga çdo lloj arme natyrore. Megjithatë, ai zotëron një forcë të posaçme që s'e ka askush: *mendjen* dhe *inteligjencën*, që mund të zbulojë dhe të krijojë çdo teshë, çdo armë dhe çdo mjet. Për këtë ai përdor mendjen dhe inteligjencën. Ata që i mendojnë dhe i shpikin gjërat e nevojshme, dhe ata që përpiken ta ushtrojnë dhe ta përsosin fuqinë e vet mendore, dallohen edhe më shumë nga kafshët. Ata që i nënçmojnë këto detyra natyrore, ndonëse jetojnë në një mënyrë që i ngjan njeriut, mbeten në lakuriqësinë natyrore, mbeten në nivelin e kafshëve të tjera dhe nuk mund të shpëtojnë e të mos jetojnë në vështirësi, mundime e rreziqe më të mëdha se ato.

Sido që të jetë, ka pasur shumë njerëz të cilët kanë lënë pa e shfrytëzuar mendjen dhe inteligjencën, këtë dhundi të madhe natyrore. Ata nuk i kanë bërë mirë as vetes, as njerëzimit. Megjithatë, njerëzit kanë gjetur gjëra shumë të dobishme, në fillim të rastësishme, e pastaj të paramenduara; kanë dalë gjithnjë e më tepër edhe njerëz që kanë zbuluar shumë të vërteta. Pasi ndonjëri prej tyre ka zbuluar një të vërtetë të vogël nga ai mal i të vërtetave, një tjetër që ka ardhur pas tij, e ka mësuar atë të vërtetë dhe, duke e zhvilluar kështu mendjen, ka mundur të zbulojë e të gjejë edhe ndonjë të vërtetë tjetër. E, kur ndonjëri ka vepruar, ka punuar dhe ka zbuluar diçka që do të ishte e dobishme për njerëzimin, tjetri që ka ardhur pas tij, e ka përsosur atë ose ka pasur aftësi që të zbulojë edhe diçka tjetër.

Në këtë mënyrë, pra hap pas hapi, është zhvilluar mendja e njeriut dhe, sa më shumë që është zhvilluar ajo, aq më tepër është larguar njeriu nga kafshët. Sipas aftësisë që i është dhënë, ai ka përparuar, d.m.th. ka dalë nga një gjendje e egër dhe ka vazhduar të qytetërohet.

Në qoftë se njerëzit do të ishin të përqendruar në një vend e të flisnin një gjuhë; të ishin në kontakte e në marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin, dhe sidomos po të mos kishte mes tyre armiqësi dhe ndarje, atëherë të gjithë së bashku do të ecnin në rrugën e qytetërimit dhe më me shpejtësi e lehtësi do të shkonin drejt pikësynimit të tyre, drejt përparimit të tyre. Por, në ato kohë të lashta, meqë kishte armiqësi dhe ndarje midis njerëzve e bashkësive më shumë se tash, meqë nuk kishte njohuri për ekzistencën e popujve që gjendeshin larg njëri-tjetrit, meqë njerëzit kishin gjuhë e besime të ndryshme dhe, meqë kishin pengesa në lidhjet e në komunikimet e tyre, gjërat e zbuluara e të shpikura dhe arritjet e tjera të një populli, mbeteshin vetëm brenda atij populli; shumë rrallë dhe vonë ato barteshin e përhapeshin tek popujt e tjerë fqinjë. Disa zbulime dhe shpikje kanë zgjuar dhe kanë aftësuar mendjet e njerëzve dhe inteligjencën e tyre, që sollën përsosjen dhe paraqitjen e shumë të tjerave. Megjithatë, ndërsa një popull përparonte e qytetërohej, një popull pranë tij mbetej në gjendje të egër.

Por, një popull që arrinte të qytetërohej, shpesh edhe pësonte ndonjë fatkeqësi, duke e humbur qytetërimin e tij. Kur zhdukej ose shkatërrrohej qytetërimi i tij, mund të barcej tek trashëgimtarët e tij, ose kalonte tek fqinjët e tij.

Kështu, dallimet midis njerëzve janë në shfaqjen e paraqitjen e këtij qytetërimi. Për këto dallime midis njerëzve, duke pasur parasysh faktorin kohor dhe hapësinor, do të ndalemi më hollësisht këtu.

2

Nuk kemi për qëllim të shtrojmë këtu çështjen e popujve, sepse kjo është jashtë temës sonë, si p.sh. të haldeasve, të asirasve (sirianëve), midiasve, indasve, egjiptianëve, grekëve, të cilët në kohë të lashta arritën në një shkallë qytetërimi dhe që i kanë shërbyer gjinisë njerëzore, dhe as të popujve të rinj të Evropës, por do të provojmë të vërtetojmë se nuk është pa qytetërim, siç mendohet në disa qarqe, periudha e kaluar 8-10 shekullore, në periudhën ndërmjet qytetërimit grek, që është më i vonshmi i atyre qytetërimeve të lashta, dhe të qytetërimit të sotëm evropian.

Evropianët kanë pohuar deri vonë se qytetërimi i sotëm ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi i vjetër grek dhe se ata që e kanë nxitur dhe që e kanë ngritur qytetërimin në Evropë, kanë qenë një grup dijetarësh grekë, të cilët emigruan në Itali gjatë pushtimit të Stambollit. Ata paskan sjellë, paskan përkthyer dhe paskan dhënë mësim në ato vende. Madje edhe sot e kësaj dite shumëkush dhe shumë dijetarë janë të këtij mendimi.

Ne nuk e mohojmë rëndësinë dhe fuqinë e qytetërimit grek; as nuk jemi nga ata që këmbëngulin se lib-

rat grekë që mësoheshin në ato vende nga dijetarët grekë, të ardhur nga Stambolli në anët e Italisë, nuk kanë ndihmuar dhe nuk kanë shërbyer në zgjimin e Evropës. Por, kurrsesi nuk mund të pajtohem i faktin se rrizuilli tokësor kishte mbetur i zhveshur dhe pa qytetërim nga dita kur pushoi qytetërimi i vjetër grek e deri në zgjimin e ngritjen e qytetërimit evropian; se çdo anë ishte zhytur dhe ishte fundosur në errësirë, në padituri dhe në egërsi gjatë tërë kësaj kohe dhe as me faktin se qytetërimi i ri evropian është rezultat pikërisht i veprave të grekëve që kishin ikur nga Stambolli.

Nëse provojmë të kërkojmë një histori të njerëzimit, që nga paraqitja e tij fillimisht, të mbështetur në parime të drejta dhe të meritueshme, nuk do të mund ta gjejmë kurrë, sepse edhe historia lidhet ngushtë me veprat dhe gjurmët e qytetërimit. Qytetërimet që janë paraqitur në rrizuillin tokësor që nga kohët e lashta, kanë bërë që pak a shumë t'i shkruajnë historitë e veta. Kështu, vetëm kohët që i ka kaluar njerëzimi në gjendje të egër dhe endacake, janë të panjohura për ne, ndërkaq, periudhat që kanë kaluar me qytetërimin, si dhe rrethanat e popujve që kanë arritur në qytetërim, deri diku janë të njohura për ne. Kur i shohim këto histori, kuqtojmë se, që nga paraqitja e qytetërimit të parë e deri në shuarjen e qytetërimit të grekëve ka qenë i pranishëm herë te një e herë te disa popuj, dhe kështu rrizuilli tokësor thuajse nuk ka mbetur asnjëherë pa të. Qytetërimi u largua disa shekuj edhe nga grekët, por nuk mundi të arrinte tek evropianët e mëvonshëm. Po t'u qasemi me vëmendje rrethanave dhe historive të

shekujve, që nga fillimi i rënies së qytetërimit të grekëve dhe fillimet e zgjimit të Evropës, si dhe shumë veprave në të cilat flitet për qytetërimin, do të vëmë re se këta shekuj nuk kanë qenë pa qytetërim, nuk kanë qenë të zhveshur nga qytetërimi. Përkundrazi, do të kuptojmë se kanë qenë të stolisur me një qytetërim më të plotë dhe më të përsosur se ata të mëparshmit. Ky qytetërim është QYTETËRIMI ISLAM.

Një popull që është endacak në gjendje të egër, nuk ka mundësi të marrë e të pranojë veprat qytetëruese të një populli të qytetëruar. Një popull i qytetëruar, ndërkaq, pasi të ketë marrë dhe të ketë pranuar plotësisht veprat qytetëruese të një populli tjetër të qytetëruar, duke i shtuar e plotësuar atij edhe vlerat e njohurive të veta, mund t'i plotësojnë dhe t'i shtojnë edhe më tej. Në këtë mënyrë, qytetërimi i mëvonshëm do të jetë gjithmonë më i plotë dhe më i përsosur se ai i mëparshmi. Prandaj, ashtu siç është qytetërimi grek më i plotë dhe më i përsosur sesa qytetërimi egjiptas e fenikas dhe qytetërimi i popujve të tjera të Azisë, qytetërimi islam, s'ka farë dyshimi, është më i plotë dhe më i përsosur se qytetërimi grek. Kjo e kaluar dhe kjo përsosje dalin në pah kur këto gjëra shikohen dhe analizohen në përgjithësi.

Veprat e qytetërimit islam nuk janë zhdukur. Meqenëse ekzistojnë dhe pjesa dërrmuese e këtyre veprave gjenden në duart e evropianëve, *realistët evropianë* këtë qytetërim nuk e mohojnë, por pohojnë se qytetërimi evropian ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi islam. Është gabim që është menduar deri më tash se qytetërimi evropian ka lindur drejtpërdrejt nga

qytetërimi grek. Dhe moszënia në gojë e qytetërimit islam nga ana e tyre, është po ashtu një gabim, që mbështetet në faktin se gjoja evropianët njihnin pak a shumë traditën dhe gjuhën e vjetër greke dhe për shkak se gjuha dhe tradita islame nuk njiheshin nga masat e gjera popullore.

Pse evropianët arritën ta kuptonin shumë vonë këtë të vërtetë, këtë barrë nuk mund t'ia vëmë fanatizmit të tyre. Duhet të mos harrojmë edhe një gjë, se janë dijetarët evropianë ata që kanë treguar se në çfarë shkalle të lartë është qytetërimi islam në ditët e sotme; se qytetërimi i tanishëm ka lindur si vijim i tij, e madje, edhe shumë e shumë vepra të paraardhësve tanë, të panjohura për ne, i kanë nxjerrë para syve tanë.

Para një kohe evropianët kanë përkthyer shumë vepra shkencore dhe filozofike të dijetarëve islamë në gjuhën latine, e cila ka qenë si gjuhë shkencore e përgjithshme e tyre në Evropë. Ato ishin vepra që në fillim kryesisht kanë zgjuar Evropën, por nuk mund t'i kishin në dorë masat e gjera popullore ato vepra të përkthyera. Meqë nuk kanë mundur t'i shihnin e t'i mësonin, nuk kishin dijeni për karakterin, përbajtjen dhe nivelin e tyre, madje as për ekzistimin e tyre. Në kohën kur dijetarët e njohur të gjuhëve islame arritën në çdo anë të Evropës, panë atje me befasinë më të madhe veprat e qytetërimit islam. I përkthyen ato në gjuhët e tyre dhe i bënë të kapshme për të gjithë. Çdonjëri prej tyre e kuptoi se për popujt islamë kishte pasur mendime jo të drejta – kjo për shkak të padisë dhe fanatizmit të tyre. Çdonjëri prej tyre sqaroi karakterin, përbajtjen, thelbin dhe nivelin e qytetëri-

mit islam, si dhe shpjegoi se qytetërimi i tanishëm evropian ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi islam. Në ditën e sotme, kjo karakteristikë është një e vërtetë që është e dëshmuar me anë të historisë dhe nuk lë vend për ndonjë kundërshtim, dyshim dhe luhatje.

Për shkak se nuk ka vepra që do të vlerësonin punën e popujve të qytetëruar të Azisë së vjetër, më i përsosuri i qytetërimeve të lashta quhet qytetërimi grek. Sado që është një e vërtetë e sigurt dhe e padiskutueshme se dijetarët grekë janë mësuesit e parë në tërë botën, tani të gjithë realistët evropianë janë të një mendjeje se shkolla e parë e popujve evropianë ka qenë Andaluzia - atëbotë në duart e myslimanëve – dhe mësuesit e asaj shkolle ishin myslimanë.

3

Një grup dijetarësh të Evropës qytetërimin islam e quajnë "*qytetërim arab*", por një lagje dijetarësh realistë vërtetojnë se ky emërtim nuk është i drejtë. Në të vërtetë, sado që shumica e veprave të qytetërimit islam janë në gjuhën arabe, gjuha arabe në atë kohë – ashtu siç është edhe sot në një farë mase – ishte gjuhë shkencore e të gjithë popujve islamë. Madje, edhe dijetarët e Stambollit, këtu e një shekull më parë, shumicën e veprave shkencore dhe letrare i shkruanin në gjuhën arabe. Për këtë janë dëshmitare veprat e dijetarëve, si: Kemal Pashazade, Ebu-s-Seudi, Mulla Gyrani, Katib Çelebiu, Ragib Pasha etj.

Ashtu siç ishte gjuha latine në atë kohë gjuhë shkencore dhe letrare e të gjithë popujve të Evropës, edhe gjuha arabe ishte gjuhë e përgjithshme shkencore dhe letrare për të gjithë popujt islamë. Persishtja dhe turqishtja përdoreshin sidomos për disa fusha të vogla që u përkisnin vetëm poezisë, traditës dhe mësave popullore. Edhe dijetarët persianë e turq, që shkruanin libra shkencorë, ashtu si dijetarët e popujve të tjerë islamë, i shkruanin në gjuhën arabe.

Ata që dëshirojnë ta quajnë qytetërimin islam qytetërim arab, harrojnë se shumica e dijetarëve që ata i quajnë dijetarë arabë, janë joarabë: turq, persianë dhe të kombeve të tjera. Ata, sigurisht, do t'i ndërrojnë mendimet e tyre nëse dinë se nga dijetarët më të mëdhenjë islamë, për shembull, Ibn Sina është persian, Hakim Farabiu është turk dhe Salahuddin Ejubi, i cili ka vënë në pah me pjekurinë më të madhe se qytetërimi islam është asi qytetërimi që do të térheqë vëmendjen e evropianëve, është kurd. Nuk ka dyshim se ata do t'i bashkohen mendimit tonë se ai qytetërim është qytetërim islam dhe se të gjithë popujt myslimanë janë pjesëtarë të atij qytetërimi.

Në kohën e lulëzimit të qytetërimit islam, gjithë popujt islamë që jetonin dhe banonin nga kufijtë e Indisë, Kinës dhe Siberisë, e deri në brigjet e oqeanit Atlantik; në Azi, Afrikë dhe në Evropë, kanë ndriçuar mendjet e tyre me dritën e atij qytetërimi. Ndonëse asokohe nuk kishte mjete qarkullimi e komunikimi të shpejta dhe të lehta si tani, prapëseprapë, sapo botohej një libër në Buhara, arrinte dhe mësohej në medresetë e Andaluzisë dhe, duke kaluar shkretëtirat

e Afrikës, arrinte në Sudan, e duke kapërcyer dallgët e Oqeanit, arrinte deri në Sumatra. Për veprat e Ibn Sinës që paraqiteshin në Lindjen e Largët, diskutohej e polemizohej në vendtubimet e dijetarëve dhe filozofëve të Kordovës, kurse për mendimet dhe idetë e Ibn Ruzhdikut, që shfaqeshin në Perëndim të Largët, diskutohej në vendtubimet e shkencëtarëve të Bagdadit. Çdo anë tjetër e rruzullit tokësor ishte e mbytur në errësirë, padituri dhe në fanatizëm. Kështu, vendet islame ishin të lulëzuara me dritën e diturive dhe me qytetërimin.

4

Qytetërimet para qytetërimit islam, kanë qenë të kufizuara dhe të veçanta vetëm për një popull e për një bashkësi. Për shembull, edhe në kohën e qytetërimit më të ndritshëm të grekëve, popujt e tjerë, që ndodheshin në vendet e largëta 40-50 orë (rrugë) nga Athina, e cila ishte djepi i qytetërimit grek, ishin në një gjendje të egër. Sado që grekët arritën të sillnin qytetërimin e vet deri në Itali e në Afrikë, nga njëra anë, dhe deri në brigjet e Detit të Zi, nga ana tjetër, qytetërimi i tyre edhe në ato vende mbeti i kufizuar dhe i veçantë vetëm për ata, kurse popujt e tjerë nuk arritën t'i fusnin në kuadër të qytetërimit të vet.

Qytetërimi islam, ndërkaq, nuk mbeti i kufizuar dhe i veçantë vetëm tek një popull dhe tek një bashkësi. Ai u shfaq pas paraqitjes së Fesë islame dhe u bë

shtyllë themelore e asaj feje. Për shkak se arriti në atë shkallë që të mund të bëhej dhe të ishte i përgjithshëm, menjëherë përfshiu dhe ndriçoi tërë anët e botës, ashtu siç përhapen dhe ndriçojnë rrezet e diellit kur lind. Dhe, duke pranuar Fenë islame, ajo filloi t'i ndriçonte dhe t'i nxirrte në dritë gjithë popujt dhe bashkësitë që hynin në kuadër të atij qytetërimi.

Qytetërimi grek dhe qytetërimet para tij, janë themeluar e janë zhvilluar në mënyrë shumë të ngadalshme, madje edhe qytetërimi i tanishëm evropian arriti të dilte në shesh vetëm pasi u kacafytën një kohë shumë të gjatë me padjeni dhe me fanatizmin shkençat, dituritë dhe e vërteta; pasi me mijëra njerëz u ngritën kundër paditurisë, mizorive dhe errësirës, duke sakrifikuar jetën e tyre për të vërtetën dhe për lirinë; pasi derdhën aq gjak dhe pasi ndodhën aq kryengritje. Qytetërimi islam, ndërkaq, u paraqit menjëherë dhe me lehtësi të madhe. Për një kohë shumë të shkurtër, duke u pasuruar dhe duke u plotësuar dhe përsosur, përfshiu tërë Botën Islame.

Për t'u qytetëruar, populli islam nuk kishte nevojë për takime dhe përvoja që në fillim, sepse i gjeti të gatshme veprat e mbeturat të qytetërimeve të popujve të vjetër, trashëgimtar i të cilëve është, domethënë, veprat e qytetërimeve të haldesve, asirasve, midiasve, egjiptianëve dhe të grekëve. Me zhdukjen e këtyre qytetërimeve, mund të formohej një qytetërim më i plotë dhe më i përsosur, ashtu siç ndodhi. Myslimanët vetëm i morën veprat e lëna të këtyre popujve të qytetëruar. Pasi gjetën shkallën dhe nivelin e të parëve dhe pasi ndriçuan e zgjuan mendjet dhe idetë

e tyre, u lëshuan dhe u shpërndanë për zbulime, shpikje dhe përvoja, kështu që atë qytetërim e ngritën dhe e përsosën në një shkallë më të lartë. Fillimisht përkthyen në gjuhët e tyre dhe i mësuan veprat e filozofëve grekë, si: të Platonit, Aristotelit, Euklidit e të shkrimtarëve, si p.sh., të Ptolemeut, pastaj i shpje-guan hollësisht. Dhe, për t'i zgjeruar arritjet e veta shkencore, për ato vepra të tyre shkruan komente, shpjegime, shënime dhe shtojca të ndryshme. Dhe në fund, u pajtuan për shumë shpikje dhe zbulime të cilat as që u kishin kaluar nëpër mendje të parëve të tyre. Qytetërimi islam u paraqit menjëherë dhe mundi të përhapej e të përsosej me lehtësi shumë të madhe.

Qytetërimi islam nuk u paraqit duke kundërshtuar, duke sakrifikuar jetë dhe duke sjellë vështirësi e fatkeqësi. Ata që kundërshtonin dhe nxirrnin pengesa në zhvillimin e në ngritjen e qytetërimit në Evropë, qenë pushtetet me fanatizmin e tyre fetar. Feja islame, ndërkaq, urdhëronte kërkimin e diturisë, të shkencës dhe të së vërtetës. Ashtu siç ishte vetë ajo që u jepte përkrahje të denjë, që i stimulonte dhe që i drejtonte ithtarët e vet në kërkimin dhe në hulumtimin e qytetërimit, edhe pushtetet islame ishin themeluar mbi bazën e parimeve islame. Pikërisht duke u ruajtur nga shtypja dhe krijimi i vështirësive, ato jo vetëm që nuk penguan paraqitjen dhe zhvillimin e qytetërimit, por madje u bënë shërbëtorët e parë të qytetërimit. Nëse i hidhet një sy historisë së popujve islame, do të shihet në mënyrë shumë të qartë sesa shërbime kanë bërë dinastia Emevite (Omajadët), qoftë në lindje qoftë në Andaluzi; dinastia Abaside,

në vendet lindore dhe mbretërit e sulltanët islamë që kanë ardhur më pastaj, - në përhapjen, në ngritjen dhe në zhvillimin e shkencave, të diturive dhe të qytetërimit në çdo anë të vendeve islame; do të shihet sesi dhe sa i kanë ndihmuar dhe i kanë përkrahur shkençtarët dhe sa e kanë lehtësuar çështjen e ngritjes dhe zhvillimit të qytetërimit.

Ja pra, menjëherë me shfaqjen e qytetërimit islam, u bë aq lehtë e shpejtë edhe ngritja, zhvillimi dhe përhapja e tij. Sikurse u shpjegua më lart, edhe pse përbazë pati qytetërimet e vjetra, feja dhe pushteti islam nuk e kanë penguar, përkundrazi, ai është zhvilluar në saje të tyre.

5

Shkaku kryesor pse e kemi quajtur qytetërim islam, nuk është se gjendet vetëm te popujt islamë, por pikërisht për shkak se është frysht i Fesë islame, nuk mund të quhet me emër tjetër përveçse kështu. Sido që të jetë, qytetërimi grek dhe qytetërimet e popujve të tjerë të vjetër, sado që i kanë shërbyer këtij qytetërimi, veprat e qytetërimit të popujve të përmendur, me kohë janë lënë pas dore, nuk janë përfillur, sepse dolën në shesh vepra akoma më të plota. Këta popuj, pasi e kapërcyen shkallën e jetës endacake, i tubuan veprat e qytetërimit të tyre, por ajo që bëri të kenë një qytetërim të ri, ishte pikërisht shfaqja e Fesë islame. Sado që ndihmuani në themelimin e qytetërimit islam,

themeli i kësaj ndërtese të re u ngrit mbi baza të drejtësisë dhe njohurive të Fesë islame. Myslimanët kanë marrë vetëm njohuritë dhe veprat filozofike e shkencore të grekëve, po nuk kanë marrë sistemin dhe rrugën e tyre. Shkurt, ata kanë shfrytëzuar dhe kanë pasur dobi nga qytetërimi grek dhe nga qytetërimi i popujve të tjerë të vjetër, por nuk i kanë imituar ata. Dhe, edhe veprat që kanë marrë, i kanë studiuar, i kanë analizuar hollësishët dhe i kanë vlerësuar e duke ua përshtatur njohurive islame, i përvetësuan. Meqë me kalimin e kohës arritën një shkallë më të lartë, qytetërimi islam, përveç që u përsos shumë më tepër se qytetërimi grek, nuk i ngjet fare atij dhe është në një formë dhe në baza krejt të tjera.

Nuk mund të themi se qytetërimi islam është prodhim mendor dhe përpjekje e popullit arab, sepse atëherë arabët edhe para Islamit do të duhej të ishin të qytetëruar në këtë shkallë dhe, së bashku me arabët, do të duhej të mos qytetëroheshin edhe popujt e tjerë islamë. Mund të themi lirisht se qytetërimi islam është fryshtë dhe prodhim pikërisht i Fesë islame, sepse ky qytetërim është paraqitur bashkë me paraqitjen e Fesë islame; ngado që ka arritur Feja islame, ka arritur edhe ai qytetërim; cilido popull e ka pranuar Fenë islame, në gjirin e tij ka hyrë edhe ai qytetërim. Ai qytetërim është rezultat dhe prodhim i Fesë islame, sepse shumë ajete urdhëruese të Kur'anit dhe shumë hadithe të Pejgamberit a.s. janë mbështetje dhe argument i tij. Ai qytetërim është prodhim i fesë islame, sepse shembujt e parë të atij qytetërimi popullit islam i janë treguar personalisht nga ana e Pejgamberit a.s.

dhe as-habëve të tij të respektuar; sepse Kur'ani Kerim është udhërrëfyes i qytetërimit; përshkruan drejtësinë dhe zbatimin e saj; vlerëson shkencën dhe diturinë. Pejgamberi a.s. urdhëron duke thënë: "Kërkoni diturinë nga djepi deri në varr", edhe "Kërkoni diturinë, qoftë dhe në Kinë"! Ashtu siç janë bërë shembull i qartë secili nga as-habët e respektuar dhe dijetarët e tjerë të mëdhenj islamë, për sjelljet e bukura dhe zemërgjerësinë e tyre, po ashtu ata nuk qëndruan anash as në shërbimet për dituri, njohuri dhe qytetërim, dhe as në dëshirën e ndërtimit të qytetërimit.

6

Popujt e Gadishullit Arabik, që është djepi i Fesë islamë, me këtë fe panë dritën e tyre. Porsa shpëtuan nga besime të kota e zakone jo të mira, shkretëtirat e atdheut të tyre u bënë të ngushta për ta, prandaj kërkuan vende ku do të jetonin më mirë dhe do të themelonin një qytetërim të ri. Kështu, këtë fe, e cila ua çeli sytë, ata e përhapën nëpër vende të tjera të botës. I shpëtuan njerëzit nga tirania e nga padituria dhe, për të përhapur një qytetërim të ri, prijësit islamë, u shpérndanë nëpër vise të ndryshme të botës. Kur drita islamë filloi të ndriçonte viset e Sirisë, Irakut, Egjiptit e Iranit, ato vise filluan një jetë të re, nisën të vëreheshin gjurmë qytetërimi, ashtu sikur toka që s'ka parë shi një kohë të gjatë, që gati ka kaluar në një tokë jopjellore, e që përnjëherë ujitet.

Ky qytetërim ndriçoi dhe u zgjerua menjëherë, ashtu si zjarri që flakëron përnjëherë. Përhapja dhe zgjerimi i Fesë islame solli përhapjen dhe zgjerimin e qytetërimit islam, dhe zhvillimi ngritja e qytetërimit islam ndihmuan përhapjen dhe përgjithësimin e Fesë islame.

Muslimanët nuk u mjaftuan dhe nuk u kënaqën me ndezjen rishtazi të një pishtari të qytetërimit vetëm në Siri e Irak dhe në Egjipt e Iran, të cilët që në krye të herës kanë qenë vende të qytetërimeve të lash-ta, por me atë pishtar, me atë mjet ndriçues ata u përpoqën të ndriçonin edhe fushat e ngrira të Tataristanit dhe shkretëtirat e djegura të Afrikës, të cilat akoma nuk kishin parë ndonjë qytetërim. Pishtarët e diturisë e të shkencës së qytetërimit Islam, të ndezur në Bagdad, Siri, Egjipt, Isfahan, Buhara, Samarkandë, Herat, Shiraz, Kirvan, Marok, Kordovë e Granadë, do të ndriçonin gjysmën e Azisë Perëndimore, gjysmën e Afrikës Veriore dhe një pjesë të madhe të Evropës. Dhe tregtarët arabë, duke lundruar në Oqeanin e Qetë, i shpëtuan nga gjendja e egër popujt e ujdhesave e të bregut perëndimor të Indisë e të Kinës dhe popujt e bregut lindor të Afrikës, të cilët pastaj vazhduan të qytetëroheshin dhe të ndërgjegjësoheshin.

Tetë-nëntë shekuj pas paraqitjes së Islamit, qytetërimi ishte vetëm në duart e muslimanëve. Në rruzullin tokësor, përveç popujve islamë, nuk kishte ndonjë komb dhe bashkësi të qytetëruar. Azinë dhe Afrikën, të cilave me luftërat dhe me shkatërrimet e vazhdueshme romakët u kishin sjellë fatkeqësi të tjera, qytetërimi islam do t'i nxirrte nga gjendja kaotike dhe e

shkatëruar. Myslimanët i gjallëruan ata me një qytetërim të ri. Edhe evropianët i shpëtuan nga veprat e tmerrshme dhe të egra, që kishin lënë popujt e egër që vërshuan nga Veriu. Janë myslimanët pra ata që u treguan popujve të këtyre anëve shembullin e një qytetërimi.

Evropianët, meqenëse nuk kishin fare njohuri mbi qytetërimin e lashtë grek, vazhdonin ta mësonin në medreset e porsahapura të Andaluzisë. Madje aty ata mësuan edhe emrat e dijetarëve të vjetër grekë. Tekstet burimore të dijetarëve grekë, si dhe shumë vepra të tyre të humbura, i morën nga përkthimet që gjendeshin në gjuhën arabe.

Kalifët¹² islamë kanë bërë përgatitjet e nevojshme për themelimin dhe ngritjen e qytetërimit islam. Kur filluan të braktisin luftimet, me tërë qenien dhe fuqinë e tyre u dhanë për gjallërimin e diturisë dhe shkencës, që janë shtyllat kryesore të qytetërimit, dhe bënë që nga të gjitha anët e botës në vendet islame të silleshin dijetarë, shkencëtarë dhe përkthyes. Filluan t'i përkthenin veprat e grekëve dhe të asirasve, si dhe veprat e tjera të vjetra; filluan të hapnin shkolla, medrese, universitete, debate shkencore etj. Harun er-Reshidi iu kërcënuar me luftë të hapët mbretit të Bizantit, me kërkesë që t'i dërgonte nga Konstantinopoli disa nga dijetarët më të njohur dhe më të zgjedhur të gjuhës greke, kurse djali i tij, El – Memuni, librat grekë dhe të tjerë të përkthyer në gjuhën arabe, i vinte në kandar dhe peshën e tyre e paguante me ar.

¹² Kalifi ishte sundimtar politik e fetar.

Para se të paraqitej Feja islame, arabët merreshin vetëm me poezi. Nga shkencat, pak njohuri kishin vetëm për astronominë, nuk vërehet asnje temë dhe asnje libër a broshurë që i përket shkencës.

Pas paraqitjes së Islamit, ndërkaq, është përsosur mjaft pastërtia dhe qartësia stilistike, si dhe u kërkuan fushat e ngushta të tjera të letërsisë. Gjuha arabe u përsos dhe u zgjerua, kurse gjuha persiane, duke u reformuar, u zgjerua mjaft dhe u bë gjuhë zotëruese e letërsisë. Edhe gjuha turke, sa filloi të shkruhej me shkronja arabe, duke u përkthyer dhe duke u zbuluar edhe shkenca të tjera të llojlojshme, nisi të përsosej e të zhvillohej me hapa të shpejtë.

Për të nxjerrë në shesh shkallën dhe thelbin e qytetërimit islam, duhet sqaruar e shpjeguar shkurtimisht se në çfarë gjendjeje ndodheshin secila nga llojet e diturive dhe shkencave te popujt islamë; duhen shpjeguar e sqaruar shkurtimisht veprat kryesore të dijetarëve të shquar që janë marrë me fusha e disiplina të ndryshme të dijes dhe të shkencës.

Astronomia

8

Në gjuhën arabe u sollën dhe u përkthyen vepra të duarnduarshme. Të ushtruarit dhe të mësuarit e tyre në Botën Islame filloi në kohën e Ebu Xhafer Abdullah el-Mensurit, i cili ka qenë kalifi i dytë i abasidëve. Ishte dashamirës i denjë i shkencës dhe i diturisë. Ai astronominë e kishte nxënë nga një dijetar indian. Këtë dije e barti në gjuhën arabe. Ndonëse dëshironte dhe kishte për qëllim ta përhapte atë në Botën Islame, më vonë, kur mori vesh se kjo shkencë ishte më e zhvilluar te grekët, hoqi dorë nga huazimi i veprave të qytetërimit të indasve, të cilët ishin më mbrapa. Tregoi interesim të madh dhe dëshirë të flaktë që t'i sillte e t'i përkthente veprat e shkencëtarëve grekë.

Atëbotë, disa dijetarë grekë nestorianë, të cilët përkrahnin idetë filozofike të Platonit, për shkak se kishin edhe disa ide të mira të tyre, që nuk i përshtatoshin fanatizmit të krishterimit, duke e ditur se do të dënoheshin dhe do të ndiqeshin nga ana e Perandorisë së Bizantit, ikën dhe qenë të shtrënguar të fshiheshin në viset e Azisë. Kishin themeluar një

shkollë në qytetin e Edesës¹³, u rrënuat dhe u shkatërrua nga Perandoria e Bizantit, nga ana e mbretërve Zinun – Izvirijan. Atëherë u shpërndanë andej – këndej; disa prej tyre shkuan madje deri në viset e Horasanit dhe atje, në Nishapor themeluan një shkollë të rëndësishme. Shumica prej tyre ndërkaq kishin mbetur në ato anë, të dëbuar e të dëmtuar, në një gjendje të mjerë.

Ebu Xhafer el-Mensuri këta dijetarë i mori në mbrojtjen e tij, me qëllim që të përfitonë nga njohuritë e shkathësitë e tyre, veçse me kusht që ata të largohejshin e të shmangeshin nga Bota e Krishterë. I përdori për të përkthyer në gjuhën arabe veprat greke të diturive e të shkencave, në mënyrë që të përhapeshin ato në Botën Islame.

9

Edhe pasardhësit e Ebu Xhaferit, duke ndjekur të njëjtën rrugë, do të përpinqeshin të shumëfishonin e të merrnin cilindo lloj të njohurive e të diturive që kishin shërbyer për zgjimin dhe zgjerimin e mendjes njerëzore në Botën Islame, në një kohë kur Evropa shtypej nën barrën e rëndë të fanatzmit dhe paditurisë. Për një kohë shumë të shkurtër, tubuan shkencëtarët më të shquar nga të gjitha viset e shteteve të mëdha që

¹³ Për qytetin e Edesës Sami Frashëri në Kamus al A'lam (vëll. II, fq. 813) shkruan se është një qytet i lashtë dhe i përmendur, që gjendet në anët e Selanikut. Emri i këtij qyteti lidhet, thotë Samiu, me një "edh". Kështu e kanë quajtur Pellazgët, e pastaj edhe shqiptarët, pra, Edese (Edhese) do të thotë "Qyteti i Edhit".

ishin në kuadër të Kalifatit Islam; përkthyen veprat më të çmuara dhe më të dobishme të dijetarëve të Greqisë dhe kështu i mbushëm bibliotekat e mëdha që patën themeluar. Në shumë shkolla të mëdha që ishin hapur në Bagdad, krahas shkencave të tefsirit dhe hadithit, mësoheshin edhe veprat e dijetarëve si: Aristotelit, Hipokratit, Galenit, Euklidit, Arkimedit, Ptolemeut etj. Edhe për diskutimet e konsultimet e çështjeve të rëndësishme shkencore dhe letrare, qenë ngritur shumë godina të mëdha. Universiteti i Bagdadit ka shërbyer jashtëzakonisht shumë për ngritjen dhe zhvillimin e astronomisë në mesjetë.

Pas Ebu Xhafer Mensurit, më i dituri, ai që më së shumti ka ndihmuar në përhapjen dhe përparimin e diturive e të shkencave ishte Memuni, kalifi i shtatë i Dinastisë së Abasidëve. Në kohën e kalifatit të Memunit, shkencat dhe dituritë përparuan dhe u përhapën në atë shkallë në Botën Islame, saqë periudha qeverisëse e tij është faqja më e ndritshme e historisë së qytetërimit islam. Në qoftë se në historinë e Greqisë së vjetër periudha e Perikliut mbahet si periudha më e fryshtshme dhe e lumtur, atëherë, edhe në historinë islame, të quhet periudha e Memunit një periudhë e tillë e fryshtshme dhe e lumtur, e meriton dhe nuk mund të merret për gabim.

Përveç Ebu Xhaferit dhe Memunit, në përparimin e diturive ndihmuan jo pak edhe Harun er-Reshidi dhe Muhamed el-Mehdiu. Edhe në kohën e qeverisjes së tyre, përveç që u përkthyen në gjuhën arabe shumë vepra greke, respekti dhe nderimi që kishin këta dy kalifë për dijetarët e nderuar, u bë shkak që të dilnin

në dritë mjaftë poetë, letrarë dhe shkencëtarë të fushave të ndryshme. Mesihullahu, astronom i njohur, Ahmed bin Muhammed Nihavendiu, i pashoq në shkençën për matjen e largësisë së yjeve me teleskop, dhe Hexhije bin Jusufi, i cili i pari solli dhe përktheu në gjuhën arabe librat matematikore të Euklidit, - jetuan në periudhën e këtyre dy kalifëve.

Asokohe te myslimanët edhe shkenca e mekanikës përparoi aq shumë, sa ora me zile, që i dërgoi kalifi Harun er-Reshid mbretit të Francës, Karlit të Madh, bëri të çuditej gjithë Evropa. Madje nuk është shkruar gjerësisht në histori sesa të shumta e sa të përsosura ishin veprat artizanale të këtij lloji në Bagdad. Njoftimet e shkruara nga ana e historianëve evropianë për orën me zile që i qe dërguar Karlit, janë argument i mjaftueshëm dhe flasin sesa e përsosur ishte shkenca e mekanikës në botën e asokohshme islame.

Memuni është ai që plotësoi dhe çoi përpara punën e Ebu Xhafer el-Mensurit. Ky personalitet mori pranë vetes dijetarët dhe shkencëtarët më të zgjedhur të kohës dhe natë e ditë përpinqej për përsosjen e shkencave e të diturisë. Mblodhi të gjitha veprat e dijetarëve grekë të Aleksandrisë, duke ua paguar shpenzimet, po ashtu edhe nga Athina mori shumë vepra greke, falë marrëdhënieve të mira që kishte me Perandorinë e Bizantit, dhe pastaj urdhëroi që të përktheshin të gjitha. Në kohën e Harun er-Reshidit, për të parën herë, Jahja bin Halidi me ndihmën e një mekasi, përktheu rishtazi tërësisht *Mexhestinë*,¹⁴ e cila

¹⁴ Vepër e Ptolemeut, me titull *Mathematike syntaxis*, e cila njihet në Evropë si Almagesti prej arabishtes al Majisti.

ishte përkthyer më parë në gjuhën arabe, dhe urdhëroi të bëheshin hartat e tabelat e plota astronomike të lëvizjeve të trupave qiellorë. Së bashku me Jahjanë, edhe Sened bin Aliu dhe Halid bin Abdulmelik Mervrudi, të cilët u përpoqën të përkthenin *Almagestin*, zbuluan disa njohuri të reja në shkencën e astronomisë dhe të astrologjisë. Këtë shkencë e zgjeruan edhe më shumë dhe qenë të suksesshëm në korrigimin e *Almagestit* të Ptolemeut.

Dy astronomët: Ali bin Bahteriu dhe Ali bin Isai, me ndihmën e dy shkencëtarëve të tjera të përmendur, pas një përvoje eksperimentale, matën dhe vërtetuan shkallët e gjatësisë dhe gjërësisë së rruzullit tokësor.

Në kohën e kalifit të Memunit, duke u mbështetur në përvojën e tij, pa u kushtuar vëmendje njohurive të mëparshme, Ahmed bin Abdullah el-Hebbashiu bëri tri tabela astronomike, duke paraqitur lëvizjet e planetëve. Edhe Abbas bin Seid el-Xhevheri, Ibn Is-hak Kesufi, Abdullah bin Sehl el-Ferganiu dhe astronomë të tjera të njohur, vepruan njësoj; ata i ngritën jashtëzakonisht emrin dhe zërin periudhës së Memunit. Këta astronomë gjetën shumë gabime në dijet astronomike të grekëve. Përveçse vërtetuan vijat e lëvizjeve të planetëve, patën sukses të zbulonin se largësia e Diellit nuk është e përhershme nga planeti i Tokës, se shenjat diellore dhe zënia a errësimi i Hënës dhe Diellit janë fenomene që ndodhin. Patën sukses të zbulonin gjithashtu shumë hollësi, lidhur me shfaqjen e kometave.

Këto personalitete që i shërbyen dhe ndihmuin kaq shumë disiplinën shkencore të astronomisë, nuk

janë të parët që kanë vënë në qarkullim këtë shkencë në Botën Islame. Para tyre, Muhammed bin Ibrahim el-Fezariu kishte shkruar një libër të mirë, ku krahasonte astronominë indase dhe greke; Ahmed bin Muhammed Nihavendiu, në Nishapor, merrej me e vëzhgimin e trupave qiellorë dhe paraqiti tabela të reja astronomike në veprën me titull "*el-Musta'mel*", ku shpjegoi adhurimin e trupave qiellorë. Pastaj, i lartpërmenduri Mesihullah, i cili kaloi tërë jetën në kohën e kalifatit të Mensurit, nxori në dritë një vepër të plotë mbi mjetet për matjen e largësisë së yjeve. Ky personalitet shpjegoi mjaft ide e mendime shkencore të pranueshme e të nevojshme lidhur me thelbin dhe natyrën e trupave qiellorë, shumica e të cilave janë vërtetuar nga zbulimet e reja të shekullit tonë.

Nga shkencëtarët me emër të kohës së Memunit, Muhammed bin Musa el-Havarizmi ishte kryesori në shkencat matematikore, dhe sidomos shquhej në shkencën e algjebrës. Me urdhrin e kalifit të përmendur, shkroi një libër të plotë mbi shkencën e astronomisë së indasve me titullin *Sind-i Hind*. Ndonëse vetë nuk ishte ndër shkencëtarët që u përpoqën e punuan në fushën e ngushtë të astronomisë, ai ka qenë nismëtar në çdo shkencë e disiplinë shkencore. Meqenëse ishte njohës i shkëlqyer i gjuhës greke dhe kishte shkathtësi të jashtëzakonshme në të shkruar, gjë që e kishte dëshmuar me hartimin e mbi dyqind vëllimeve, ia rriti vlerën periudhës së udhëheqjes së Memunit. Ky personalitet, përveç që përktheu në gjuhën arabe mjaft libra grekë, të papërkthyer deri në atë kohë, duke u bërë edhe disa komente e shpjegime me

shënime, i çoi më tej dhe dha idetë e zbulimet e veta. Ndër veprat e tij janë: një shkrim i plotë mbi vlerat dhe dobitë e filozofisë; një libër me titull *el-Hikmetud-dahilije* ("Filozofia e brendshme"); një numër shkrimesh lidhur me logjikën dhe filologjinë, shkencat matematikore, aerologjinë, optikën, astronominë etj. Pastaj, ai pati shumë shkrime në mjekësi, dhe mbi të gjitha ai ka shkruar edhe një vepër të mirë për përgatitjen e barnave.

Nga nxënësit e të lartpërmendurit, Ebu-l-Masherit, i njohur ndër dijetarët evropianë me emrin "Albumazar", është marrë kryesisht me astronomi, më vonë, sipas ideve dhe zbulime të veta, ka bërë një tabelë të re astronomike të lëvizjeve të trupave qiellorë me titullin *Zixh ebi-l-Ma'sher* ("Tabela astronomike e Ebu el-Masherit").

10

Edhe pas vdekjes së Memunit, astronomia nuk mbeti pa përparime. Musa bin Shakiri së bashku me tre djemtë e tij: Muhammedin, Ahmedin dhe Hasanin, e zgjeruan dhe e quan përpara këtë shkencë. Shumë të tjera pas tyre kanë bërë të njëjtën punë, prandaj Ibn Junusi i ka vlerësuar lart ato vepra. Në librin me titullin *ez-Zixh el-Hakimijj*, iu afroa deri diku së vërtetës se deri në ç'largësi gjendet Dielli nga planeti i Tokës dhe, sado që nuk iu dha rasti të zbulonin faktin se Toka rrrotullohet pa lëvizur Dielli, sidoqoftë, e shpje-

guan, madje pér këtë arritën dhe në hollësi, se pér sa kohë përfundon rrotullimi vjetor.

Observatori i këtyre tre vëllezërve gjendej në urën *Babu-t-Tâk* të Bagdadit. Nga aty ata vëzhgonin zënien e Hënës a Diellit, korrigjonin idetë e disa paraardhësve të tyre dhe dhanë njohuri shumë të dobi-shme pér madhësinë e rrizuillit të Hënës. Ahmed, që ishte i mesmi i këtyre tre vëllezërve, ishte i zoti edhe në shkencat e mekanikës. Ai ka bërë zbulime e shpikje të jashtëzakonshme. Muhammedi (Ebu Xhafer bin Musa bin Shakiri), që ishte më i madhi prej tyre, ka shpjeguar lëvizjet ditore të trupave qiellorë dhe pér çdo ditë bënte kalendarin. Dijetari i njohur Thebit bin Kurre, në astronomi ka qenë nxënësi i këtij të fundit.

Pasi kishin nxënë bazat e metodat kryesore të shkencave dhe njohuritë e zbuluara para tyre, dijatarët islamë, duke u mbështetur në ato, kryenin eksperimente e bënин përpjekje pér të zbuluar të vërteta të tjera të panjohura. Këto metoda shkencore që i sollën evropianët e sotëm në shkallën më të lartë të qytetërimit, u ndihmuani e u shërbyen pa masë edhe dijatarëve islamë. Ata mbështeteshin në këto metoda shkencore. Kështu, i përmenduri Thebit bin Kurre, ndër të parët në botë ka menduar pér përdorimin e algjebrës në gjeometri. Ai thuajse ringjalli shkencën e gjeometrisë dhe, krahas ndihmesave të jashtëzakonshme në shkencat matematikore e në të tjerat, studioi zbulimet e paraardhësve të tij në shkencat e astronomisë. Pasi lodhi mendjen një kohë të gjatë me prova, me keqardhje tregoi se nuk kishte mundur të bënte

ndonjë zbulim në këto shkenca. Megjithatë, ndonëse nuk ishte i kënaqur me ndihmesën që dha përkthetë këto shkenca, përktheu rishtazi dhe në mënyrë të plotë *Almagestin* e Ptolemeut dhe, pasi plotësoi korrigimet e dijetarëve islamë që u përmendën më lart, shtoi edhe disa studime të vetat. Ndonëse disa dijetarë evropianë e fajësuan këtë personalitet për shpjegimet që kishte dhënë lidhur me lëvizjet e trupave qiellorë, ato mendime nuk ishin shpikje e tij, por mendime pa mbështetje të trashëguara nga grekët.

Edhe faqet e gjata historike që kaluan midis periudhës së tre djemve të Musa bin Shakirit dhe periudhës së astronomit Betani, janë të stolisura e të mbushura me studime e zbulime të dijetarëve, si të: Ebu-l-Abbas Fadl bin Hatem en-Niriziut, Muhammed bin Isait, Ebu Abdullah el-Mehaniut etj.

Niriziu qe më i dituri i kohës në shkencën e gjeometrisë dhe të astronomisë. Vërtetoi e korrigjoi shumë e shumë studime e zbulime të astronomëve islamë të kohëve të Memunit. Shkroi komente e shënime plotësuese në *Almagestin* dhe, afër një shekull pas vdekjes, mbetej një personalitet i respektuar dhe i pranuar në mesin e dijetarëve islamë. Bëri emër edhe për hartimin e tabelave të reja të posaçme astronomike. Edhe pse Ibn Junusi nxori në pah disa gabime të këtij personaliteti, e pranon se ai kishte dhënë një ndihmësë të madhe në përparimin e kësaj shkencë.

Mehaniu, dijetar i madh, sado që është paraqitur si matematikan në përbledhjen e njohur të biografive me titull *Kutuphane-i Hukema* ("Biblioteka e dijeta-

rëve") të Zevzenisë¹⁵, ka punuar mjaft edhe në astronominë, sidomos duke i regjistruar ngjarjet astronomike, si për shembull, zënien e Hënës e Diellit, qasjet e rastësishme të trupave qiellorë etj., që ndodhnin gjatë kohës së tij; la një vepër që do të shërbente mjaft në zgjerimin dhe përparimin e diturive e të shpikjeve të ndryshme.

Betaniu, edhe pse vetë nuk ka bërë zbulime në astrologji dhe në astronomi, duke ndjekur rrugën e Ptolemeut, ka tubuar diturinë dhe zbulimet e dijetarëve islamë që njiheshin deri në kohën e tij; kishte shkruar një vepër të madhe si *Almagesti*. Me këtë vepër fitoi autoritet të madh, duke lënë anash veprat e parardhësve të tij që kishin bërë disa zbulime, disa prej të cilave ishin zhdukur krejtësisht nga faqja e dheut. Shumë zbulime të dijetarëve islamë i vishen Betaniut, ashtu siç i vishen Ptolemeut zbulimet e qytetërimit grek. Sidomos evropianët, gati të gjitha zbulimet astronomike i lidhin me emrin e Betaniut, që e njojin me emrin *Albatini*. Nga të gjitha, thuhet se ai paskësh argumentuar sesa vonohet brenda vitit ardhja e Diellit, në krahasim me Tokën, në pikën e qillit në mes të ditës, kështu që mbetja pas e vitit grek nga viti frëng për dymbëdhjetë ditë, ndodhë për këtë shkak. Veç këtij korrigjimi, nga rrotullimi që bën rrëth Diellit Toka, një çështje e panjohur te grekët, tregoi sesi një sipërfaqe e rruzullit mbetet pa dritë. Që Dielli herë është më afér Tokës e herë më larg saj, të gjitha këto i kishin zbuluar dijetarët islamë të kohës së Memunit, para Betaniut.

¹⁵ Është një qytezë, ndërmjet Horasanit dhe Heratit që, për shkak se ka pasur dijetarë të famshëm, është quajtur "Basra e Vogël" (Kamus al-a'lam, IV, f. 2430.)

Edhe ky i fundit, që ka jetuar në shekullin e katërt të hixhretit (d.m.th. shek. 10), kishte mbledhur zbulimet e paraardhësve të tij, në mënyrë që të mësoheshin më shumë dhe më lehtë. Në observatorin në Rakka, ai vërtetonte dhe korrigjonte njohuritë e zbuluara nga eksperimentet. Nuk mund t'i mohohet as puna dhe ndihmesa shumë e madhe që ka dhënë në Universitetin e Bagdadit, dhe në përgjithësi ndikimi tek pasardhësit e tij.

Gjatë shekullit të sipërpërmendur, sado që ndër astronomët islamë, të cilët dhanë ndihmesa për zgjerimin dhe përparimin e dijeve me metoda eksperimentale, ka emra të njohur, si: Sehl bin Beshshari, Muhammed bin Muhammed bin Jusuf es-Samarkandiu, Ali Ebu Hasan bin Ismail el-Xhevheriu, Ebu Xhafer bin Ahmed bin Abdullah ibn Hebbashi, Muhammed bin el-Husejn bin Hamid ibn el-Edemi dhe Kusta bin Lluka, që u rrit në frysë e qytetërimit islam dhe shkroi libra të frazeologjizmave arabe; në shekullin e lartpërmendur në shkencën e astronomisë më së shumti kanë kontribuar djemtë e Emaxhurëve turq.

Ali bin Emaxhuri dhe djali i tij Ebu-l-Hasan Ali bin Emaxhuri, të njohur me mbiemrin Benu Emaxhur, bënë hulumtime dhe eksperimente të njëpasnjëshme për gjysmë shekulli dhe nxorën në dritë një vepër të plotë me emrin *el-Bedî`*. Ata përdorën një metodë të re të hulumtimeve në fushë të astronomisë. Të dy dijetarët e sipërpërmendur kishin një rob. Edhe ky personalitet me emrin Muflîh të cilin e arsimuan dhe e liruan, u ndihmoi shumë. Muflihu shkroi edhe vetë vepra. Ai arriti të njihte disa dukuri që lidhen me lëvizjet e Hë-

nës, të panjohura për paraardhësit e tij. Edhe Ebu-l-Hasan Ali bin Emaxhuri nxori në dritë të dhëna të rëndësishme për formën e Hënës, duke konstatuar se skajet e Hënës për së gjeri nuk janë gjithnjë të përhershme.

11

Kalifi i dymbëdhjetë i dinastisë së Abasidëve, i cili erdhi në pushtet pas Memunit, mblodhi dijetarët më të shquar të kohës, por ndërsa po përpinqej t'i shpinte përpara shkencat dhe dituritë, vendi i tij vazhdonte të zvogëlohej gradualisht. Ashtu siç i dolën nga dora Andaluzia, Magrebi, Afrika dhe Egjipti, edhe në viset e Horasanit e Iranit filluan të çonin krye disa prijës fisesh. Kalifati i Bagdadit gati po ndahej dhe rreziku gjithnjë e më tepër po shtohej. Megjithatë, rruga që ndiqej për shkencat dhe dituritë, nuk ishte e pafriztshme. Përveç në Bagdad, shkenca e astronomisë studiohej me interesim të madh edhe në Damask, Shiraz, Samarkandë, Nishapor etj., pra ajo vazhdonte të zhvillohej. Vetëm se me shtimin e principatave të Iranit dhe kur nisi të binte fuqia dhe autoriteti i kalifëve abasidë, edhe shkencat e dituritë që ishin duke përparruar gjithnjë me ndihmën e këtyre kalifëve, u gjendën në rrezik të madh.

Aduddevle¹⁶ dhe Sherefuddevle¹⁷, nga mbretërit e dinastisë së Buvejhítëve¹⁸, kur vërejtën se filloi të binte

¹⁶ Erdhi në krye të dinastisë së Bu ejhitëve më 372/982. Për shkak se ishte shumë i suksesshëm mori ofiqin Shahinshah "mbreti i mbretërve".

niveli i shkencave e i diturive, ndezën rishtas pishtarët e diturisë dhe u përpoqën të mos harrohej kënaqësia e qytetërimit. Aduddevle mori pranë vetes dijetarët më të mëdhenj që mbeten pas vdekjes së Benu Emaxhurëve, si dhe Ebu-l-Kasim Ali ibn-ul-Hunejin, i njohur me emrin *Ibn A'lem* dhe filloi të mësonte prej tij disiplina të ndryshme shkencore. I lartpërmenduri, i cili ishte nga dijetarët e kohës, ka qenë autor i një vepre të plotë, që bënte fjalë për trupat qiellorë dhe astronominë, me titull *Feleknuma*, diskutonte e polemizonte vazhdimisht me Abdurrahman Sufiun për çështje shkencore, e sidomos për astronominë. Sjelljet e dijetarëve në këtë mënyrë quhen nder, krenari.

Aduddevle, ndonëse nuk fitoi emër sa Memuni, nuk mbeti pas tij në ndihmesën që dha për qytetërimin isalm. Edhe në kohën e sulltanatit të tij, Universiteti i Bagdadit filloi të lulëzonte e të kthente lavdinë e mëparshme. Dijetarët islamë që ishin nën mbrojtjen e këtyre mbretërve, Abdullah Ibn el-Hasan Ebu el-Kasim dhe Kalveziut, ishin të privilegjuar. Edhe Xhaferi, djali i Muklefë Bil-lahit, nga kalifët abasidë, ka shkruar një vepër shumë të rëndësishme për kometat. Hasan bin Ahmed Hamedani, me origjinë nga Jemeni, nën mbrojtjen dhe nxitjen e Sherefuddevles dhe Ebu Naser el-Kumiut etj. kanë jetuar si shkencëtarë në atë kohë në Siri.

Ebu Sehl el-Kumiut, Ebu el-Fidaiut, Ebu Bekr bin Sabri, Ebu Husein el-Hizaiut, Ebu Is-hak Ibrahim Hil-

¹⁷ Është bir i Aduddelvet.

¹⁸ Dinasti në kohën e Abasidëve më 335/946 në viset e Iranit dhe të Irakut.

li, Ebu Saad Fadl Shiraziu, Ebu el-Hamidi bin Muhammed es-Saganiu, Ebu el-Hasan el-Magribiu etj. bënë emër në kohën e sulltanatit të Aduddevles dhe Sherefuddevles. Ndihmë të madhe në disiplina të ndryshme shkencore dhanë sidomos Kumi u dhe Ebu el-Vefai, mbi të gjithë punuan në fushën e astrologjisë dhe astronomisë. Arritën mjaft sukses në përpunimin e veprave shkencore në Universitetin grek të Aleksandrisë. Edhe Is-haku diskutonte e polemizonte me kënaqësi gjithnjë për shkencat matematikore dhe astronomike. Shkrimet e tij u gjasojnë artikujve shkencorë që botohen tanë në Evropë nëpër gazeta e revista. Ishte i zoti në shkencat e mekanikës. Observatorët, veglat, mjetet dhe objektet e tjera, për të cilat flitej asokohe vetëm në histori, u nxorën në dritë me mundin dhe përpjekjet e këtij personaliteti. Në vitet e para të shekullit të pestë sipas hixhretit (shek. 11), në Bagdad, mjeti që përdorej për matjen e largësisë së yjeve, ishte i gjatë njëzet e një këmbë e gjysmë, kurse i njëjti mjet i Muhammed Haxhindit, që përdorej po në atë kohë, ishte i gjatë afër gjashtëdhjetë këmbë.

Ebu el-Vefai lindi në vilajetin e Horasanit. Në vitet e para të shekullit të pestë erdhi në Bagdad. Filloi të bënte korrigjin e përmirësimin e shumë gabimeve të astronomëve të mëparshëm. Shkroi një libër të plotë për astronominë me titull *ez-Zîxhu-sh-Shâmil* ("Tabelat e përgjithshme astronomike") dhe, për të dhënë mjaft njoħuri dhe zbulime të dobishme, shkroi edhe një vepër tjetër me titull *Almagesti*. Kjo vepër është më e plota nga të gjitha shkrimet e shkencëtarëve islamë, njëkohësisht edhe nga veprat që u ka më-

suar evropianëve shumë gjëra nga qytetetërimi islam. Se në çfarë shkalle kishin përparuar shkencat në Botën Islame, po edhe metodat përmesat e largësisë dhe veprimet e tjera gjeometrike, kuptohet qartë nga studiimi i *Almagestit* të Ebu-l-Vefait. Kur Hëna gjendet në një pikë që të formojë një trekëndësh me planetin e Tokës dhe Diellin, nën ndikimin e dy trupave qiellorë, e ndërron vendin. Evropianët ia quajnë Tiko Brahes, një nga astronomët e Danimarkës, përcaktimin e lëvizjes dhe të pozicionit të Hënës, pra këto dukuri kanë qenë të njoitura edhe nga dijetarët e mëparshëm islamë. Edhe ndërrimi i vendit dhe i rrugës së Hënës është zbuluar më përpara, siç u përmend më sipër. Kjo çështje shpjegohet në mënyrë të qartë në *Almagestin* e Ebu-l-Vefait. Në përkthimet që i janë bërë librit të sipërpërmendur në gjuhët evropiane, janë bërë përpjekje t'i shtrembërojnë e t'i tregojnë gabimisht copat përkatëse, porse kjo e vërtetë, megjithatë, nuk mund të fshihet. Për këtë shkak, edhe pse evropianët i ngatërrojnë e i përziejnë thesaret e qytetërimit islam, nuk ka dyshim se sot edhe këto zbulime të mëdha, hulumtuesit realistë do t'i njojin që të gjithë. Sado që në kohën e shkencëtarëve islamë, që janë udhërrëfyes kryesor të shkencëtarëve të sotëm, nuk ishin zbuluar teleskopi e as mikroskopi, që janë vegla shumë të nevojshme përmesat e astrologjinë dhe astronominë, prapëseprapë në këto shkenca, edhe pa këto mjete, janë bërë zbulime të mëdha e të çuditshme nga dijetarët islamë. Askush nuk mund të mohojë se këto zbulime që lidhen me këto shkenca, u përkasin dijetarëve islamë.

Në Lindje, koha e zbulimeve dhe e përsosjes së shkencave astronomike e matematikore, që u zgjeruan me ndihmën dhe përkrahjen shumë të madhe të kalifëve abasidë, mbaron me Ebu-l-Vefain. Pas tij meriton të përmendet Harun bin Aliu, i cili, për të çuar më tutje diturinë e mëparshme tregoi zotësi të madhe në hartimin e tabelave astronomike, në ndërtimin e veglave për vëzhgim dhe aparatave për matjen e largësisë së yjeve.

12

Në ato kohë, d.m.th. në shekullin e pestë të hixhretit, në vendet e Lindjes, që po kalonin anarki politike e grindje të vazhdueshme, në çdo anë filluan të formoheshin mbretëri të reja. Asnjëra nga ato nuk e mendonte se gjendja e sigurisë, e ardhmërisë dhe e bashkimit do të mund të arrihej duke luftuar për ngritjen e shkencës e të diturisë. Prandaj, në Universitetin e Bagdadit, nga dita në ditë, rënia dhe padija po ngadhënjenin përballë dijenisë. Pas grindjeve e mos-pajtimeve të vazhdueshme mes gaznevinjëve e sel-xukëve dhe mbretërive të fiseve të tjera, nga verilindja depërtuan furishëm hordhitë mongole e tatara të Xhingis-Hanit. Ashtu siç i zhdukën dhe i shkatërruan ata veprat kulturore e shkencore dhe përgjithësisht gjurmët e qytetërimit që gjetën para tyre, ashtu edhe disa popuj barbarë evropianë, me fanaticizmin e tyre të krishterë, u vërsulën drejt vendeve islame. Filluan t'i

nënshtronin popujt islamë në Afrikë e Siri. Kjo periu-dhë kohore qe periudha e rënies dhe e fatkeqësisë më të madhe pas sukseseve, përparimit dhe arritjeve të mëdha të popujve islamë. Megjithatë, shkencat, dituritë dhe qytetërimi islam kishin ndriçuar aq sa të mos shuheshin me lehtësi. Prapëseprapë, vepra të mbetura të qytetërimit islam do të gjendeshin gjithandej. Madje, edhe djali dhe pasardhësi i Xhingis-Hanit pranuan e përqafuan fenë islame dhe qytetërimin e saj. Vetë ata u vunë në shërbim të denjë të veprave të qytetërimit, të cilat baballarët e tyre ishin përpjekur t'i zhduk-nin e t'i shkatërronin. Por shkëlqimi i mëparshëm u arrit në Azi. Ai pishtar islam vazhdoi të ndriçonte edhe në Afrikë, dhe në Andaluzi.

13

Egjipti u nda nga kalifati i Bagdadit (nga Dinastia e abasidëve) dhe u bë qendër e pushtetit të fatimijve në shekullin e pestë të hixhretit. Fatimijtë ndoqën shembullin e abasidëve. Ata filluan të tubonin dijetarët e shquar dhe në këtë mënyrë filluan të jepnin ndihmesën e tyre në zgjerimin dhe përparimin e shkencave e diturive. Në kohën e sulltanatit të Abdulazizit e të Hakimit kishte dijetarë të mëdhenj, sidomos, falë zbulimeve e shpikjeve të suksesshme të Utqiut e të Ibn Junuzit, ata fituan rnder dhe emër të madh.

Ibn Junuzi pati zotësi të jashtëzakonshme në shkençën e astronomisë. Shpiku një orë me zile dhe një mjet

për vëzhgimin e trupave qiellorë, duke arritur në atë shkallë që t'i zinte vendin Ebu-l-Vefait. E kalonte kohën në observatorin që kishte themeluar, në malin Maktem, dhe pasi kreu shumë eksperimente lidhur me trupat qiellorë, për problemet astronomike shkroi një libër të plotë me titullin *ez-Zixhu-l-Hâkimijj*, i cili zuri vendin e *Almagestit*. Komentet, shënimet dhe të gjitha shkrimet e plotësimet e tjera të mëparshme që kishin shkruar shkencëtarët e Bagdadit për këtë libër u braktisën, u lanë pas dore. Ai libër filloi të mësohet në çdo anë të botës islame. Është përkthyer në gjuhën persiane nga dijetari i njojur Omer Kajami; në gjuhën greke nga Kari-siu Kukah dhe në gjuhën kineze nga Ku-Shu-Kengu. Nasiruddin Tusiu, pasi e kishte studuar mirë këtë libër, me urdhrin e Hulagu Hanit, shkroi librin *Ezjâxhu-l-Hâmije*.

Në udhëtimin që bëri në Egjipt, aty nga fundi i shekullit të pestë sipas hixhretit, Ibnu-n-Nebidiu trigon se në bibliotekën e Kajros paskësh gjetur gjashtë mijë libra vetëm mbi astronominë, dhe dy rruzuj qie llorë të vizatuar, njëri nga Ptolemeu e tjetri nga Abdurrahman Sufiu.

Më i madhi dijetar pas Ibn Junuzit, që ka jetuar në Egjipt në kohën e sulltanatit të Fatimijve, ka qenë Hasan ibn Hejthemi. Ky personalitet ka shkruar mbi tetëdhjetë libra. Ai ka komentuar edhe *Almagestin* e Ptolemeut dhe *Mukadimen* e Euklidit; ka shkruar një vepër që përmban studime të llojlojshme e të hollësishme mbi astronominë. Ky i fundit, për fat të keq, nuk gjendet sot dhe ky është një dëm i madh. Ka shkruar dhe një vepër shumë të rëndësishme mbi

shkencat matematikore me titullin *el-Ma'lumatu-l-Hendesije* ("Njohuritë gjeometrike").

14

Veprat shkencore të qytetërimit islam në perëndim të Afrikës (Magreb) dhe në Spanjë, edhe pse kanë dalë më vonë se veprat e qytetërimit në kalifatin e Lindjes, nuk janë të një shkalle më të ulët. Medresetë e përsosura, universitetet, vendtubimet shkencore dhe bibliotekat shumë të mëdha që gjendeshin në Kordova, Sevilje, Granadë, Meresi dhe në të tjera qendra të Andaluzisë e të Afrikës Perëndimore, të mbushura përplot me libra të llojeve të ndryshme, ishin në atë nivel që do t'u bënин konkurrencë medreseve dhe bibliotekave të Bagdadit, Shirazit, Samarkandës, Nishaporit, Damaskut dhe Egjiptit. Por ç'dobi, kur fundi i popujve islamë u bë ende më tragjik: shumica e atyre veprave të qytetërimit u zhdukën dhe breznitë e më-pastajme nuk mundën t'i shfrytëzonin, ndaj nuk qe e mundur të kuptohej plotësisht shkalla dhe niveli i qytetërimit islam.

Shkencëtarët e dijetarët islamë të Afrikës Perëndimore: Ibn Zerkale, Muslimetu-l-Magrebiu, Umer Ibn Halduni, Jakub ibn Tariku, Ibni Ebi Thulte Ibnu-l-Mesihi, Xhebbbar ibn Eflahu, Ibnu-r-Ruzhdiu dhe të tjerë përparuan në një shkallë shumë të lartë.

Muslimetu-l-Magrebiu kishte shkurtuar veprën e Betaniut dhe kishte bërë një vepër të re, kështu që më

vonë *vepra Ezjâxh Alfonsije*, që është e para e këtij lloji në gjuhën latine, është kompletuar me disa njohuri të marra nga kjo vepër e tij. Ibn Thulte kishte kaluar tridhjetë vjetë duke hulumtuar dhe duke bërë eksperimente astronomike. Edhe Ibn Zerkale ka kryer shumë prova e eksperimente. Ky ka shkruar shumë studime shkencore për largimin dhe afrimin e Diellit ndaj Tokës dhe për faktin sesa vonohet brenda vitit për të arritur në pikën e mesditës (meridianit).

Shkencëtari i sipërpërmendur, vonimin e Diellit për atë vit e paraqet për afro dyzet e nëntë-pesëdhjetë shkallë, gjë që në ditët e sotme është arritur të vërtetohet saktësisht se është pesëdhjetë shkallë. Ibn Zerkale, për të kryer eksperimente, kishte themeluar vetë një observator. Sipas asaj që ka treguar Mekarriu, orët që kishte zbuluar dhe kishte vënë në veprim shkencëtari i sipërpërmendur, i paskëshin mahnitur të gjithë në qytetin e Toledos. Ndonëse shumica e shkrimeve të tij nuk ekzistojnë, përkthimet e disa broshurave të tij që gjenden në bibliotekat e Evropës, tregojnë shkallën e rëndësinë edhe të veprave të tjera dhe flasin vetiu sesa dëm i madh ishte humbja e tyre për botën e qytetuar. Ibn Adhrai, i cili e çmonte dhe respektonte Ibn Zerkalen, ka treguar se ai nuk kishte mundur të kuptonte se Dielli është në qendër, por e kishte kuptuar se ai nuk mund të sillet rrëth Tokës dhe kishte supozuar se është i mundshëm rrrotullimi i tij rrëth një planeti tjetër.

Ibni-r-Ruzhdi ka jetuar në Spanjë në shekullin e gjashtë sipas hixhretit (shek. 12). Ai u mor me dituritë dhe përparoi shumë në hulumtimet e tij në astronomi, në mjekësi dhe filozofi. Në secilën nga këto shkenca

ka lënë vepra të konsiderueshme. Në filozofi dhe në misticizëm ka drejtimin e tij personal. Shkroi një koment të hollësishëm për *Almagestin*. I lartpërmenduri kishte vënë re një njollë mbi Diellin dhe, kur e kishte studuar mirë atë, kishte kuptuar se pikërisht ishte koha kur Merkuri duhej të kalonte ndërmjet Diellit dhe Tokës. Me këtë ai kishte shpjeguar që një pjesë e zënies së Diellit shkaktohet prej këtij pozicioni.

Edhe mjaft shkencëtarë që jetuan e vepruan në Spanjë, kanë shkruar libra për fusha të ndryshme shkencore, por shumica e këtyre shkrimeve e veprave nuk ekzistojnë, janë zhdukur. Te popujt islamë u dëbuau dhe u nxorën me dhunë nga trojet e veta, por edhe tek ata që shpëtuan prej ngjarjeve tragjike që kanë ndodhur herë pas here, nuk ndeshen zbulime e shpikje të reja, siç shihen në veprat e shkencëtarëve të Lindjes. Kjo gjë vërehet vetëm përmes sqarimeve dhe shpjegimeve të hollësishme.

15

Edhe shteti më i largët perëndimor i Afrikës, d.m.th. shteti që asokohe është quajtur Magreb, e sot quhet Marok, nuk ka qenë i zhveshur nga qytetërimi i përgjithshëm islam. Qytetet i tij: Tangjer, Fasi dhe Marakeshi kishin rivalitet me qytetet e Kordovës, Seviljes dhe Granadës së Spanjës. Shkencëtarët më të njojur të Magrebit janë Bitraxhi dhe Ebu-l-Hasani, veprat e të cilëve arritën në duart e breznive të më-

vonshme, duke u shpëtuar shtrëngatave të kohës. I pari prej tyre ka qenë bashkëkohës i Ibni-r-Ruzhdiut. Ai merrej me studimin e astronomisë dhe thoshte se të gjithë trupat qiellorë rrrotullohen rrëth planetit të Tokës, pa pasur rrugë. Sidoqoftë, edhe pse nuk ia doli të zbulonte të vërtetën, edhe ky, ashtu si Ibn Zerkale, e kuptoi se planeti i Tokës nuk është qendër dhe lehtësoi rrugën për zbulime të reja.

Edhe Ebu-l-Hasani, i cili jetoi në shekullin e shtatë sipas hixhretit (shek. 13), që kishte njohuri të gjera mbi shkencën e astronomisë e të matematikës, duke e shëtitur anembanë Spanjën dhe Afrikën Veriore, zbuloi shumë gjëra dhe caktoi shkallën e gjatësisë e të gjerësisë së shumë qyteteve. Përveç këtyre, ai dha shumë dëshmi me eksperimente dhe ndihmesa në shkencën e gjeografisë fizike e natyrore me veprën *el-Mebâdi ve-l-Mekâsid*. Para disa vitesh kjo vepër u përkthye në gjuhën frënge dhe evropianët mësuan shumë gjëra që ishin të panjohura deri në atë kohë për ta, kurse qytetërimi evropian iu shtuan shumë njohuri.

Dijetarët islamë të kohës janë anash normën e respektit e të nderimit ndaj çdo ideje dhe shkolle të paraardhësve të tyre. Pikëpamjet dhe shkollën e Ptolemeut i braktisën dhe i korrigjuan plotësisht. Duke mos pranuar se planeti i Tokës është qendra e botës, ata i hapën rrugë zbulimit të madh të Kopernikut.

16

Anët lindore të shteteve islame, Azia dhe Egjipti, pas shekullit gjashtë të hixhretit (shek. 12), siç kemi thënë edhe më lart, ishin në flakë e gjak. Pas Gaznevinjëve, selxhukëve dhe fatimijve, kalifatin e Bagdadit e shkatërruan plotësisht mongolët. Në Egjipt, pas fatimijve erdhën ejubinjtë.

Këtë herë, qeveritë islame nuk mund të gjenin aq kohë për t'i ndihmuar dituritë dhe shkencat, si në kohën e kalifëve abasidë, por, megjithatë nuk i linin pas dore dijetarët islamë, thesaret dhe shërbimet e njohurive, as në ato pështjellime të mëdha. Edhe në këto kohë të vështira pati shumë dijetarë e shkencëtarë. Dijetarë të mëdhenj të shekullit të gjashtë sipas hixhretit kanë qenë Ibn Sinai, Kaziriu, Fet-hi Ibn Nexhbe, Tenuhiu, Hasan Ibn Musabbah, Muhammed Ibn Umer el-Furkan etj. Më vonë, d.m.th. në shekullin e shtatë sipas hixhretit, shërbime shumë të mëdha në fusha e në disiplina të ndryshme shkencore kanë bërë: në Damask, Tefiki; në Isfahan, Abdullah bin Shakir bin Ali bin Mat-har el-Medeni; në Bagdad, Ebu Ahmed el-Gazaliu, Hibetullahu dhe el-Haseniu; në shekullin e tetë të hixhretit (shek. 14): në Isfahan, Ebu Hanife; në Bagdad, Mubeshir bin Ahmed; në Hora-san, Nasiruddin Tusiu etj.

Në atë kohë të gjitha viset islame kishin rënë në duar të zjarrputistëve të Mongolisë dhe të popujve të paqytetëruar të Tataristanit e Turkestanit. Këta push-tues kishin robëruar popujt e qytetëruar të vendeve

që i kishin zaptuar, porse qytetërimin e tyre kurrë nuk kishin mundur ta zhduknin. Duke parë se të nënshtruarit ishin shumë më përpara se ata në shkencë, në dituri dhe në qytetërim, nënshtreesit, ashtu si të nënshtuarit, u detyruan të pranonin fenë, gjuhën dhe qytetërimin e popujve të qytetëruar që gjetën aty. Kështu, qytetërimi islam nuk humbi as në tragjedi kaq të mëdha, përkundrazi, u bë shkak që ta mbështesnin atë vetë ata. Sulltan Mahmud Gazneviu thirri dhe priti në pallatin e vet dijetarin e madh, Biruniun. Ai i respektoi dhe i nxiti dijetarët e kohës. Edhe Xhelaluddin Melikshah- Selxhuki sarajet e veta do t'i bënte vendtubime të dijetarëve. Në pushtet i vinte dijetarët dhe kalendarit të ri që e zbuloi, ia vuri emrin *Târih-i Xhelâlij*.

Djali i Xhingis-Hanit, Hulagu, posa e pranoi fenë islame, nisi të zgjeronte qytetërimin islam e t'i përparronte shkencat dhe dituritë. Të gjitha punët ia la dijetarit Nasiruddin Tusiut, i cili ndodhej gjithnjë në shoqëri me të, ndërkaq djali i madh i Xhingis-Hanit, Kublai, dituritë i shpuri deri në Kinë. Për t'i përhapur e për t'i popullarizuar ato, ai kishte marrë me vete, për shoqërim shkencëtarin e madh, Xhemaluddinin. Edhe Sulltan Mehmed bin Kelavuni, që ishte nga memlukët, mori nën mbrojtje dijetarët më të dëgjuar në Damask. Ibn Shatiri, një nga shkencëtarët që ishte nën mbrojtjen e tij, merrej me astronomi, me sistemin e tabelave astronomike, të bazuar në ato të paraardhësve.

Edhe sulltanët e mëdhenjë osmanë, ndonëse ishin të zënë gjithë kohën me pushtime dhe me zgjerimin e shtetit, nuk i lanë në harresë dhe nuk i zhvlerësuan

shkencat e njohuritë, përkundrazi, dijetarët i mbronin dhe nuk i ndanin nga vetja. Nipi i Timur Hanit, Ulug Beu ndërtoi në Samarkandë një observator me shumë instrumente me përmasa të mëdha. U mor edhe vetë me astronomi. La një vepër me të cilën dëshmon rëndësinë dhe gjithanshmërinë e vet, tregon zgjuarsinë dhe shkallën e dijes së vet.

17

Popujt e qytetëruar e të prapambetur, që u vërsulën në botën islame nga Lindja dhe Veriu, pasi ngadhënjyen në luftë, u mundën dhe u nënshtuan para diturive, shkencave dhe qytetërimit islam. Prandaj, është ky një argument i fortë e i mjaftueshëm që tregon shkallën dhe forcën e qytetërimit islam.

Biruniun (Ebu-r-Rejhan Muhammed bin Ahmed), që e thamë më lart se ishte nën kujdesin e Sulltan Mahmud Gazneviut, duke qenë shkencëtar i madh dhe i informuar fare mirë për çdo shkencë, sulltani i porsapërmendur, në ekspeditën që bëri në Indi, e mori me vete dhe e vuri në kontakt me dijetarët indas. Ai dëshironte të përfitonë diçka nga shkencat dhe dituritë e posaçme indase, por, kur e pa se shkenca indase ishte shumë më prapa, bëri të kundërtën, u dha zbulimet dhe shkrimet e dijetarëve të Bagdadit, e bashkë me to edhe përshkrimet e veprave të dijetarëve grekë. Kjo u bë shkak që në Indi të hynte e të përhapej qytetërimi islam. Ndër dijetarët islamë të Lin-

djes e të Perëndimit, Biruniu mbahet nga më të më-dhenjtë (imam) në shkencat e astronomisë, gjeografisë dhe të matematikës. Shkrimet e tij në secilën nga këto shkenca për shumë kohë u përdorën si manuale në Botën Islame.

Omer Kajami (Umer el-Hajjami) dhe Abdurrahman Hazeniu, që ishin nën kujdesin e Melikshah Selxukut, me eksperimentet astronomike që kryen, me njohuritë e tyre, arritën të korrigjonin kalendarin vjetor iranian dhe të sistemonin kalendarin vjetor "Xhelali".

Dihet se sistemi diellor i përdorur nga grekët, është me të meta, sepse çdo viti i mbeten nga disa minuta. Këtë gabim që evropianët e kuptuan shumë më vonë, e kishin kuptuar dhe e kishin korrigjuar që në atë kohë këta të dy: Omer Kajami dhe Abdurrahman el-Hazenu. Kalendari vjetor "Xhelali", të cilin e sisteman ata të dy, pothuajse nuk ka dallim thelbësor nga kalendari vjetor i tanishëm frëng (evropian).

Nasiruddin Tusiu, që ka qenë më i dalluari i dijetarëve të tubuar në selinë e Xhingis-zade Hulagu Hanit, vërejti se po i bëhej respekt dhe nderim i madh nga ana e këtij zotëriu të ri (nga Xhingis-zade Hulagu Hanit – M.P.), prandaj, mori krahë e guxim të themelonte në Merage një observator me pajisje të plota; t'i mbledhë librat shkencorë në të gjitha anët: në Havarizm, Siri, Bagdad, Mosul etj., e të formonte një bibliotekë të madhe. Ai bëri shumë mjete e vegla të ndryshme që u përkisnin matjeve të trupave qiellorë dhe shkencave matematikore e fizike, zbulime këto të paraardhësve të tij, me ndihmën edhe të dijetarëve të tjera, si: Muhjiddin Dimishkiu, Fahrudin Halati-i Tifli-

siu, Nexhmuddin Kazviniu, Fahrudin Merage-i Musuli, Muhjiddin Magribiu etj., për dymbëdhjetë vjet rresht nxorën në dritë një vepër të madhe me titullin *Ezjâxhu-l-Hâmije*. Meqë kjo vepër paraqet pikëpamje të përgjithshme, kuptohet se shumë gjëra, me ndonjë modifikim të pjesërishëm, janë marrë nga libri *Ezjâxh Hâkimije* të Ibn Junuzit. Është kritikuar ashpër, por megjithatë nuk i ka humbur vlera. Përmbledhjet që i bënë kësaj vepre Ali Shah Buhariu, Nexhmudin Nebudu dhe Gijathuddin Xhemshid bin Sa'ad el-Hatibiu, u pranuan me kënaqësi dhe kështu u lejua të mësohej në të gjitha medresetë e shteteve islame, deri në shekullin e tetë, sipas hixhretit (shek. 14), kur pa driten vepra *Ezjâxh* e Ibn Shatirit.

Një i quajtur Xhingis-zade, edhe pse sundoi në Iran, në një mënyrë i bëri shërbim qytetërimit islam. Vëllai i tij, Kublai Hani, ndërkaq, pushtoi Kinën. Me ndihmën e shkencëtarit të njohur, Xhemaluddinit, të cilin e mori me vete, ai ia doli që njohuritë dhe shkençat islame t'i sillte madje deri në kryeqytetin e Kinës. Atje, me ndihmën e Ku-Shu-Kengut, bëri të përktheeshin në gjuhën kineze e të përhapeshin në mënyrë të rrufeshme veprat islame, si *Ezjâxh Hâkimije* e Ibn Junuzit e të tjera.

Pas Nasiruddin Tusiut, emër të madh krijoi Maru-dh-Dhikr ibn Shatiri, me prejardhje nga Damasku. Shkrimet e tij të sistemuara zunë të mësoheshin në të gjitha medresetë. Shemsuddin Halebiu, Shehabuddin Ahmed bin Gilumullah ibnu-l-Hasibi dhe Ibn Zurejnu-l-Hajri, sado që u munduan dhe u pajtuan t'i braktisin e t'i linin pas dore shkrimet e Ibn Shatirit,

nuk ia dolën dot, përkundrazi, librat e tyre mbetën nën hijen e veprave të tij. Shkrimet e Ibn Shatirit vazhduan të gjzonin respekt të madh, atë famë që e kishin edhe më parë.

Ndërsa Ibn Shatiri ishte i zënë në Damask me kërkime, studime e shkrime, nga Turkestani doli edhe një pushtues i ri i botës, ai ishte Timurlengu. Ky ripërtriu atë që kishte bërë Xhingis-Hani. Ndonëse i zhduku shumë vepra të qytetërimit islam dhe ndonëse shkatërrroi mjaft vendbanime, u bë deri diku i njojur në astronomi, filozofi dhe në shkenca e tjera. Nuk ishte krejtësisht i zhveshur nga shija e qytetërimit, sepse, ndërsa në disa vende bëri shkatërrime të mëdha, në disa të tjera, për shembull, Samarkandën që e zgjodhi kryeqytet, i rindërttoi dhe i stolisi me shumë vepra shkencore e qytetëruese. Pas vdekjes së tij, shumica e vendeve të pushtuara, i dolën nga dora djalit të tij. I biri, Shahrahu, meqë ishte njeri i dhënë pas qejfeve e ahengjeve, kryeqytetin e barti në Herat. Kishte qëllim t'i udhëhiqte mirë vetëm vendet që i kishin mbetur, kurse djali i tij, Ulug Beu, që nga vegjelia kishte dëshirë shumë të madhe për mësimin e shkencave matematikore, fizike dhe astronomike. Meqenëse këto shkenca i hulumtonte, për ta plotësuar dëshirën në këtë punë, mori leje nga i ati dhe mbeti në Samarkandë. Aty ndërtoi një observator shumë të madh dhe, duke e pajisur me vegla e mjete të nevojsqme, shumë kohë u mor me hulumtime e eksperimente në fushë të astronomisë. Në këtë disiplinë shkencore la pas vetes një vepër të plotë, me qëllim që emri i tij të mbetej kujtim i përhershëm për njerëzit.

min. Observatori që ndërtoi Ulug Beu në Samarkandë, ishte i lartë afér njëqind këmbë, d.m.th., ishte i lartë pothuaj sa kubeja e Shën Sofisë. Sidoqoftë, mënyrën e ndërtimit të observatorit dhe mjetet e tjera nuk i shpiku ai, sepse, siç kemi thënë edhe më lart, ato i patën shpikur kaherë shkencëtarët islamë. Megjithatë, janë për t'u vlerësuar mjetet dhe pajisjet e këtilla që krijuan njohuritë dhe qytetërimin e Ulug Beut. Me fjalë të tjera, ai ndërtoi një observator të pa-shoq deri në atë kohë. Duke qenë vetë princ dhe nip i pushtuesit të botës, tërë jetën e përqendroi në dituri; thënë më drejt, përqendrimin në dituri e njohuri, e vlerësonte krenari, fisnikëri dhe madhështi.

Dijetarët më me emër që tuboi Ulug Beu pranë vetes, kanë qenë: Hasan Çelebiu, i njohur si Kazi-zade, Gajjath Melihuddin Xhemshidi dhe Ali bin Muhammed Kushxhiu. Djali i Kazi-zades, Mirim Çelebiu, komentoi librin e Ulug Beut,

Një shekull e gjysmë pas Ulug Beut nisi veprimtarinë Kepleri i famshëm. Meqë ai zbuloi dhe argumentoi se Dielli është i palëvizshëm dhe se është Toka ajo që rrrotullohet, mund të shihet si nxënësi i fundit i Universitetit të Bagdadit, që me pikëpamjet e tij në astronomi, i ngjante Ulug Beut.

Shkencat matematikore

18

Deri këtu shpjeguam përparimet dhe zhvillimet e bëra nga dijetarët e shkencëtarët kryesorë islamë në astronomi. Dijetarët islamë për t'i cuar dituritë astronomike në shkallën e dëshiruar, qenë të detyruar të përpinqeshin për t'i shpënë më përpara edhe shkencat matematikore, të cilat i zgjeruan dhe i ngritën aq shumë, saqë meritojnë të quhen shpikës të atyre shkencale. Evropianët shkencat matematikore i morën nga dijetarët islamë për t'u shtuar atyre gjëra fare të pakta.

Dijetarët islamë kanë dhënë ndihmesa jo vetëm në matematikë, gjeometri e algjebër, të cilat pothuajse i shpiken rishtazi, por kanë dhënë shumë edhe në shkencat e mekanikës e të optikës. Veprat mbi makinat ajrore e ujore të Heronit dhe të Eksipejosit qenë përkthyer në gjuhën arabe që në fillim të qytetërimit islam.

Hasan bin Hejthem, që u përmend më lart, ka shkruar libra që përbajnë shumë njohuri e shpikje mbi optikën, si: *Ru'jet-i Mustekîme* "(Shikimi i drejtë"), *Ru'jetu Mun'akise* ("Shikimi i pathyer"), *Mer'atu Muhrrika* ("Pasqyra lëvizëse") etj. Edhe el-Hazeni, i cili u përmend po ashtu më lart, ka shkruar një libër të tërë mbi optikën, ku janë përbledhur njohuri të hollësishme e të plota mbi përthyerjet e pamjes dhe të dritës;

vendin që ka lënda reflektuese në pasqyrë; në çfarë mënyre nxjerrin nxehħesi thjerrēzat; madhësia e rreme e lëndëve që shihen në disa gjendje; pēr c'arsye duken mē tē mëdhenj Dielli dhe Hëna kur janë në horizont etj.

Vitlioni, inxhinier polak që shkroi i pari në Evropë një libër mbi optikën, nuk ka shpjeguar asgjë mē tepēr se ato që kishte në veprën e tij dijetari islam, el-Hazeni. Me një problem shkencor që eshtë rrahur e zbérthyer në librin e pērmendur tē el-Hazenit, janë marrë një kohë tē gjatë matematikanë tē shquar evropianë, si: Esluçi, Hygensi dhe Barovo, por pa sukses, dhe në fund atë problem arriti ta zbérthente Marki Simson. Edhe ky, ndonëse dihet vendi i trupit që do tē shohë syri, bën pērthyerje (reflektive) mbi një pasqyrë tē rrumbullakët dhe pērcakton pikën e saj, rregulla këto që analizohen në gjeometri.

Dijetarët islamë, matematikën dhe gjeometrinë i morën nga grekët, kurse algjebrën thuajse e shpikën vetë, prandaj, e quajtën "*el-Xhebru ve-l-Mukabele*".

Nuk eshtë e vërtetë se këtë shkencë e morën nga India, sepse indasit, pērveç disa shpikjeve greke që kishin depërtuar në viset e tyre pērimes nestorianëve, kanë treguar vetë se nuk kishin diçka shkencore origjinale tē tyren. Ka mundësi që nga India t'i kenë marrë numrat, porse dijetarët islamë i pērmirësuan ato dhe, duke i pērmirësuar, i vunë në qarkullim me disa forma. Ato shifra që u pērdorën te dijetarët arabë tē Magrebit (Afrika Perëndimore) dhe tē Spanjës janë tē njëjtit numra që pērdoren tani në çdo anë tē Evropës. Prandaj, edhe nëse myslimanët nuk janë shpikësit e numrave, janë, së paku, pērhapësit dhe bartësit e tyre.

Që në kohën e kalifit Memun, që u përmend më lart, u përkthyen arabisht veprat e matematikanëve grekë, si: të Euklidit, Tejodusit, Alfonjosit, Hepesiklosit, Minlausit, e të tjerëve. Dijetarët islamë këtyre përkthimeve u bënë komente, shpjegime, i pasuruan me shënime plotësuese dhe pastaj shkruan edhe tekste të reja, duke i çuar përpara ato shkenca dhe duke zbatuar rregullat e algebrës në gjeometri. Për t'i marrë si shembull e për t'u mbështetur te dijetarët islamë, evropianët prej kohësh, dëshironin t'i shihnin përkthimet e veprave greke nga shkencat matematikore, sepse dijetarët islamë, duke i mësuar përmendsh përkthimet e shumë veprave greke, tekstet e të cilave nuk ekzistonin, përveç shërbimit që zbulimet e bëra greke të arrinin tek breznitë e mëvonshme, kishin gjetur dhe zgjidhur edhe rregulla dhe probleme shkencore, për të cilat grekëve as që u kishte vajtur mendja. Sidomos, meqenëse trekëndëshi kënddrejtë dhe sfera janë dy nocione shumë të nevojshme për shkencën e astronomisë, mund të thuhet se dijetarët islamë pothuajse kanë hedhur themelët e këtyre disiplinave shkencore. Librat e matematikës dhe sidomos ato të teknikës të Hejthemit, Senxharit, Muzaffer Es-ferudinit, Ibn Ruzhdit dhe të dijetarëve të tjerë të mëdhenj islamë, që gjenden edhe sot e kësaj dite, si dhe letërkëmbimet shkencore mes tyre, të cilat ishin në nivelin e një gazete shkencore, të Ebu-l-Vefait dhe të dijetarëve të tjerë të mëdhenj islamë, janë argument i mjaftueshëm që tregon se në çfarë shkalle kishin përparuar shkencat matematikore në botën islame. Dijetarët islamë kanë treguar sesi numrat e panjohur

në algjebër e në matematikë paraqiten me shkronja, si dhe shumë shenja të algjebrës e të matematikës.

Shpikjet dhe përparimet në shkencat matematikore të dijetarëve të Bagdadit kuptohen nga libri i Beta-niut, që është një përbledhje e shkurtër e veprave të tyre. Shkencat matematikore pas tij kanë përparuar edhe më tej me punën e: Muhammed bin Musai, Ebu-l-Vefai, Ibn Junuzi, Ebu-l-Hasan Aliu, Ibn Hejthemi dhe shumë dijetarëve të tjera. Veprat e dijetarëve të tillë nuk gjenden sot. Edhe ato që ekzistojnë, meqë nuk u kanë rënë në dorë evropianëve, shpikjet dhe përparimet e shkencave matematikore të popujve islamë nuk ka qenë e mundur të njihen.

Dijetari Muhammed Bagdadiu ka shkruar një libër të plotë për matjen e sipërfaqes së tokës dhe përpilimin e hartave, duke i shtuar këtij libri edhe një varg çësh-tjesh që lidhen me matjen dhe ndarjen e largësisë. Metodat dhe mësimet e dijetarit të lartpërmendur janë të pranueshme dhe të zbatueshme edhe sot.

Si rrjedhim i përparimit të gjeometrisë dhe mekanikës në Botën Islame, u shpikën vegla të ndryshme për përcaktimin e kohës dhe u bë ndarja e fushës së orës, ku tregohen orët dhe minutat. Edhe kjo është vepër e dijetarëve islamë, ashtu si është shpjeguar në librin e Ebu-l-Hasan Magribiut.

Veprat e përkthyera në gjuhë evropiane të dijetarit të përmendur, i kanë dhënë shumë njohuri qytetërimit të tanishëm mbi shkencat matematikore.

Gjeografia

19

Në fillim të kalifatit të abasidëve, kur zunë të formoheshin shoqata shkencore dhe të përktheheshin vepra shkencore greke, u përkthye edhe vepra matematikore e Ptolemeut, e quajtur *Almagesti*, si dhe gjeografia e tij. Dijetarët islamë nuk pranonin gjë pa e vërtetuar e provuar, prandaj, duke e parë të domosdoshme edhe për rastin e kësaj shkence, me urdhrin e kalifit Memun, u nisën komisione e u bënë prova në fushën e Senharit, që çuan në korrigjimin e shkallëve të gjerësisë e të gjatësisë, të dhëna në Gjeografinë e Ptolemeut; iu shtuan shumë shpjegime mbi Gadishullin Arabik, Irakun, Sirinë dhe Iranin; u përmirësuan hartat, u përgatit një gjeografi e plotë me emrin *Resmu-l-Erd* ("Paraqitja e tokës") dhe u përpilua një hartë.

Pas Ptolemeut, me gjeografi janë marrë edhe të krishterët, si në Perandorinë e Lindjes, ashtu dhe në Perandorinë e Perëndimit, shumica e të cilëve sipërfaqen e Tokës e kujtonin katrore, e disa në formë rrethi, për ta nxjerrë vetëm Jerusalemin si qendër. Dijetarët islamë ndërkaq, për të mos rënë në gabime të këtilla, posa e përkthyen Gjeografinë e Ptolemeut, i ndreqën gabimet dhe të metat e saj dhe e plotësuan. Këto korrigjime e plotësime u bënë në tri periudha:

Periudha e parë. - Myslimanët, meqë për më tepër kishin njohuri për më shumë se gjysmën e anëve të rruzullit tokësor, të njohura deri në atë kohë, nuk hasën në vështirësi për ta zgjeruar gjeografinë me njohuri, dëshmi dhe zbulime të reja të tyre. Në vendet islame, që asokohe shtriheshin nga Kina e deri te brigjet e oqeanit Atlantik, ishin të hapura të gjitha rrugët përtregti; marrëdhëni dhe kontaktet në mes shteteve islame ishin në një shkallë të mirë. Këto rrugë kryesore përbëheshin nga katër drejtime:

I pari: fillonte nga Tangjeri e Andaluzia, nëpër Evropë, domethënë pasi kalonte nëpër Francë, Gjermani dhe nëpër vendet sllave, hynte përsëri nëpër vendet islame; duke kaluar nëpër Turkistan shkonte deri në Belh, Kabul dhe Kashmir.

I dyti: fillonte përsëri nga anët veriore të Andaluzisë, pasi e kalonte ngushticën e Gjibraltarit, nëpër anët veriore të Afrikës, domethënë kalonte nëpër Magreb, Algjeri, Tunizi, Tripoli, Bengazi dhe nëpër Egjipt arrinte në Damask, nëpër luginën e Eufratit, arrinte në Bagdad e në Basra. Dhe një drejtim, duke kaluar nëpër vendet perse dhe nëpër Kirvan e Beluçistan, shkonte deri në Sindi e Indi.

I treti: ishte vija detare që kalonte nëpër brigjet e Detit Mesdhe e Algjeri dhe arrinte në brigjet e Sirisë. Prej aty, përsëri me rrugë detare, arrinte në brigjet e Indisë dhe në ujdhesat e Oqeanit Paqësor.

I katërti: fillonte përsëri nga Deti Mesdhe dhe, pasi kalonte ngushticën e Suezit, përsëri nëpër Detin e Kuq dhe bashkohej me rrugën e tretë në detin e Omanit dhe në Oqeanin Indian.

Ja pra, këto rrugë që përshkoheshin paprerë nga tregtarët dhe vizitorët islamë, kanë bërë që ata edhe të shpinin qytetërimin islam në vendet e largëta, të vazhdonin marrëdhëniet dhe kontaktet tregtare e shkencore, nga njëra anë, po edhe të bënин shërbime të mëdha në zhvillimin e shkencës së gjeografisë, nga ana tjetër.

Shkrimet e Ibn Hukalit, Istekriut dhe Mesudit, që dolën në atë kohë, domethënë, në shekullin e katërt të hixhretit, përmajnë shumë e shumë zbulime e njo-huri të reja gjeografike dhe tregojnë sesa i kishin studiar dijetarët islamë anët e rruzullit tokësor, që nji-heshin deri atëherë.

Këto zbulime përbëjnë periudhën e parë të përparrimeve të dijetarëve islamë në fushë të gjeografisë. Në këtë periudhë u bënë të njohura shumë anë të botës që ishin të panjohura për grekët. Nëse harta është zgjruar mjaft shumë, atëherë gjeografia fizike ka mbetur me zbulimet e dijetarëve islamë të mëparshëm të cilët përgatitën veprën *Resmu-l-Erd* "Paraqitja e Tokës".

Periudha e dytë. – Periudha e dytë e përparrimeve gjeografike në Botën Islame fillon në shekullin e pestë të hixhretit, me daljen e Biruniut, shkencëtar i mirënjohur. Biruniu së bashku me Ebu-l-Vefain dhe me dijetarë të tjera të drejtuar ka qenë nga të rrallët dhe punonte në Universitetin e Bagdadit, por sulltan Mahmud Gazveniu e tërhoqi prej andej dhe e mori me vete në udhëtimin në Indi, nëpër Beluçistan e Afganistan, dhe në Turkmenistan. Korrigjimet që i kishin bërë autorët e librit *Resmu-l-Erd*, për Irakun dhe rrethinën e tij, ky i plotësoi me Indinë, Beluçista-

nin, Afganistanin, Turkestanin dhe me viset e Brahmaputrës. Dhe, duke shtuar shumë njoħuri e zbulime tē reja pēr ato anë, ai shkroi një libér gjeografie tē plotësuar me titullin *Kānūn*. Kjo gjeografi, mē drejt, ky libér, mē vonë əshtë plotësuar e korrigjuar shumë nga Hushjari, dijetar iranian.

Edhe Omer Kajami që pērpunoi kalendarin "Xehlali", bashkë me disa korrigjime tē tjera pēr viset e Anadollit, i ka bërë shumë sherbime edhe gjeografisë fizike. Nga libri i Nasiruddin Tusiut kuptohet shkalla e njoħurive gjeografike, që patēn arritur dijetarët islamë, lidhur me Azinë.

Gjeografét e tjerë islamë mē tē famshém tē kētij shekulli, ishin Bekriu, Idrisiu dhe Jakut Hameviu. Jakut Hameviu ka lénë një fjalor gjeografik tē plotë, tē hartuar sipas alfabetit. Idrisiu, i cili lindi në Sebte tē Marokut, mbaroi studimet në Universitetin e Kordova. Qëndroi në pallatin e mbretit tē Sicilisë, ku shkroi një vepér gjeografike tē pērsosur dhe pēr mbretin béri një glob tē madh prej argjendi, tē rruzuillit tokësor, duke vizatuar mbi tē hartën e njoħur deri në atē kohë. Harta e Idrisiut əshtë pērdorur në Evropë pēr disa shekuj, me korrigjime tē pjesshme.

Periudha e tretë. – Në periudhën e parë u bënë korrigjime tē viseve që gjedeshin në pjesët qendrore tē vendeve islame. Në periudhën e dytë, nderkohë që u bënë korrigjime tē hartave tē viseve në anët lindore tē vendeve islame, pēr anët perëndimore, d.m.th. pēr Afrikën dhe Spanjën u bënë hulumtime tē mjaf-tueshme pēr ato që janë dhënë në veprën *Resm-l-Erd* dhe në *Kānūn* tē Biruniut. Sido qē tē jetë, Ibn Zerkale,

që jetoi në shekullin e pestë në Andaluzi, përcaktoi shkallën e gjerësisë e të gjatësisë të disa qyteteve të Spanjës, u përcaktua shkalla e gjatësisë së Detit të Mesdhe 42° , që ishte paraqitur: 62° në veprën *Almagest* dhe 54° në *Resmu-l-Erd*. Sado mjaft afër së vërtetës, edhe këto zbulime mbeten të panjohura, prandaj, në shekullin e shtatë të hixhretit, Ebu-l-Hasan Aliu, që jetoi në Marok, duke rrokur në tërësi edhe rrethanat e viseve perëndimore të vendeve islame, shkroi një vepër shumë të mirë të gjeografisë, e cila, ashtu si vepra e tij për astronominë, e vlerësuar lart, u ofroi evropianëve shumë njoħuri të dobishme dhe të rëndësishme.

Me këtë vepër Ebu-l-Hasani plotësoi gjeografinë e vendeve islame. Pas tij erdhën shumë dijetarë që shkruan libra gjeografik mbi bazën e njoħurive të arritura. Më të njoħurit ishin: Ebu-l-Fidai, që ishte pushtetar i Sirisë; Nuvejri, që bëri një përmbledhje të madhe për shkencat në Egjipt; Makriziu, Ibnu-l-Verdiu, Ibn Abbasi, Hasani; ky i fundit, pasi e ndérroi fenë, hyri në lagjen e dijetarëve latinë dhe është i njoħur me emrin Afrikalli Lijun, e të tjerë. Ibn Betuta, që lindi në Sebte (të Marokut – M.P.), duke bërë udhëtime të gjata në Lindje, arriti deri në Tataristan, Indi dhe Kinë. Në ato vende kishte regjistruar çdo gjë që kishte parë dhe kishte dëgjuar. Pas njëzet vjetesh, ai bëri një udhëtim në Afrikë, duke depërtuar në Sudan, e madje edhe në vendet e pashkelura. Edhe këtë udhëtim e përshkroi, por, meqenëse disa nga gjërat që kishte dëgjuar i shkroi pa i vërtetuar sa duhej, libri i udhëpërshkrimeve të tij nuk gjeti shumë mbështetje. Megjithatë, për hulumtimet që bëri ai, nuk është një vepër e padobishme.

Djali i Timurlengut, Shahruhu, pas ardhjes në froni e Iranit, për të vendosur marrëdhënie miqësore me Indinë dhe Kinën që i kishte fqinjë, dërgoi në Kinë një delegacion në nivel të ambasadës. Edhe push-tetarit të Kalkutës i kishte dërguar Abdurrezak Samarkandin, një nga dijetarët e mëdhenj të kohës. Këta ambasadorë i kishin dërguar njohuri të shumta gjeografike lidhur me Indinë dhe Kinën, prandaj, djali i Shahruhut dërgoi në Kinë një udhëtim të posaçëm Ali Kushxhiun, dijetar i kohës, në shoqërim edhe të Ulug Beut. Me këtë rast, Ali Kushxhiu bëri korrigjimin e shkallëve të gjatësisë së tokës dhe, duke shënuar shkallën e madhësisë së rruzullit tokësor, i bëri një shërbim të madh gjeografisë islame. Edhe gjeografia e Katib Çelebiut është një vepër e përsosur, por, meqë ka kaluar në radhën e veprave të reja, nuk mund të quhet vepër e qytetërimit islam.

Dijetarët islamë kanë bërë edhe hartën e lundrit mit në dete. Meqë grekët nuk patën ndonjë sukses në këtë punë, edhe kjo konsiderohet zbulim i qytetërimit islam. Më 1497, portugezi i njohur, detari Vasko de Gama, i cili ka zbuluar shumë ujdhesa të oqeanit Paqësor, kishte përfituar shumë nga një hartë detare e shkruar në gjuhën arabe, të cilën e kishte me vete një mysliman në ekuipazhin e anijes së tij.

Shkencat natyrore

21

Dijetarët islamë, ashtu siç i kanë bërë shërbime të mëdha njerëzimit në matematikë, në astronomi, astrologji, mekanikë, optikë e gjeografi, kanë bërë shërbime të mëdha edhe në dituritë filozofike e të shkencave të natyrës. Edhe në këto fusha ua kanë kaluar paraardhësve të tyre grekë. Prandaj ata e kanë merituar të quheshin edhe shpikës të këtyre diturive.

Kimia ka përparuar shumë nga dijetarët islamë. Sidoqoftë, edhe alkimia, që mbahet si dije e rreme, ka qenë në përparim të vazhdueshëm sepse, edhe eksperimentet e alkimisë, duke nxjerrë në shesh substanca, elemente të tjera të lëndëve dhe përbërjet e tyre, kanë ndihmuar në përparimin dhe zhvillimin e kimisë së vërtetë. Veprat e Xhabir Ebu Musa Xhafer Kufiut, që jetoi dhe veproi në shekullin e tretë sipas hixhretit (shek. 11), dhe të Ebu Bekr er-Raziut, që jetoi dhe veproi në gjysmën e parë të shekullit katër të hixhretit, janë të mjaftueshme për të treguar përparimin e kësaj shkence. Përftimi i acidit sulfurik, i acidit nitrik, i ujit mbretëror; mënyra e prodhimit të zhivës dhe lëndëve të tjera acidike, janë shtjelluar gjërësisht në veprat e kimistëve të lartpërmendur. (Shihni dhe Mukadimen e kimisë së të ndjerit Aziz Beu).

Kur u përhapën gjithandej në shumë anë të botës, myslimanët panë bimët e çdo klime dhe atyre të përmendura në librin e Dioskoridit, që e kishin përkthyer nga gjuha greke, iu shtuan edhe 2000 lloje të reja të bimëve, të cilat nuk ishin të njohura fare për grekët.

Në librat që shkroi Ibn Sinai mbi mjekësinë, shënonë shumë bimë të panjohura deri në atë kohë. Djemtë e Ibnu-r-Ruzhdit, me ndihmën e tij i dhanë mbretit të Spanjës, Ferdinandit të dytë shumë njohuri për bimët. Abdurrahmani i parë, kalif i Andaluzisë, bëri një kopsht jashtëzakonisht të madh e të pasur të bimëve në rrethin e Kordovës. Për t'i sjellë bimët që nuk gjendeshin aty, ai kishte dërguar udhëtarë të posaçëm në vise të Afrikës dhe Azisë.

Bimët mjekësore, si: zhurbane, darçin, tamarin, sina, kamfur etj., që nuk ishin përdorur më parë, dhe përdorimi i sheqerit në vend të mjaltit për përgatitjen e ilaçeve, janë shpikje të dijetarëve islamë. Mjekët islamë zbuluan se me sheqer bëhen sherbeti dhe ëmbëlsira të ndryshme. Ata treguan edhe mënyrën e ruajtjes së bimëve e të frutave.

Në barnatoret e Andaluzisë dhe të vendeve të tjera islame caktoheshin nëpunës të posaçëm, të cilët kishin për detyrë të kujdeseshin që barnat mjekësore të paprishura të mos shiteshin me çmime shumë të larta. Kështu kontrolloheshin dhe barnatoret e hapura nëpër qytetet e vogla dhe nëpër fshatra. Tërhiqej vërejtja dhe nxitej gjetja e çdo lloj bari.

Dijetarët islamë zbuluan se edhe bimët janë të seksit mashkullor e femëror. Ata shpikën lloje veglash të posaçme bujqësore dhe shkruan shumë libra për bujqësinë.

Lajli, një nga dijetarët anglezë, në parathënien e librit të tij të gjeologjisë, ka vënë në dukje se dijetarët islamë kanë qenë të parët që janë marrë edhe me shkencën e gjeologjisë. Ashtu si veprat e vlefshme të Kazviniut, dijetar i madh, që përbajnë njoħuri të shumta pér bimët dhe shtazët, edhe Demiriu shkroi një vepér shumë të përsosur pér shtazët. Prandaj, shkencëtarët evropianë me të drejtë këtë të fundit e quajnë Byfoni i arabëve.

Bimët e pemët që janë tani në Evropë, sidomos shumica dërrmuese e luleve, janë marrë nga myslimanët e Andaluzisë.

Mjekësia

23

Edhe mjekësia ka përparuar te myslimanët, ashtu si dhe shkencat e tjera. Jahja bin Miskevejhu, që ka qenë mjeku i kalifit Harun er-Rashid, ka shkruar rreth tridhjetë vëllime të vlefshme mbi farmaceutikën, ethet, pastërtinë dhe përdorimin e ushqimit, rrufën, banjat, dhembjen e kokës dhe për tema të tjera mjekësore. Këto vepra, disa origjinale e disa të përkthyera hebraisht, kanë arritur në duart e evropianëve. Hunejni, një nga nxënësit e të sipërpërmendurit, u dërgua në Greqi, me detyrë që t'i mblidhte veprat shkencore të dijetarëve grekë. Këtë detyrë e kreua dhe, kur u kthye në Bagdad, përktheu veprat e Galenit dhe të Hipokratit. Shkroi dhe shumë vepra mbi mjekësinë e logjikën. Pos këtyre dy mjekëve, ndonëse në kohën e abasidëve kishte edhe më shumë mjekë islamë, më në zë megjithatë kanë qenë: Ebu Bekr er-Raziu dhe Ebu Ali Sina, veprat e të cilëve kanë shërbyer si bazë pune jo vetëm ndër popujt islamë, por një kohë relativisht të gjatë edhe në Evropë.

Ebu Bekr Raziu kishte mbledhur të gjithë librat e shkruar para tij për mjekësinë, dhe i kishte studiuar hollësisht. Ai kishte themeluar spitale në Bagdad, Rej-

dhe në Nishapor. Përveç librit mjekësor me titull *Hâvî*, në të cilin trajtonte tema në mënyrë të hollësishme, ka lënë edhe një vepër mbi sëmundjet e lisë e të fruthit. Me këtë u bë i dëgjuar në Evropë. Dhjetë vëllime të librave mjekësorë që i shkroi në emër të Mensurit, qeveritar i Horasanit, nga dinastia e sasanidëve, të përkthyer e të botuar në Venedik në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, u bënë shkak që autorit të përmendur t'i rritej emri edhe më tepër në Evropë. Tërë veprat e shkruara nga ai përbëjnë mbi dyqind vëllime. Të tijat janë këto zbulime: përdorimi i kimisë në mjekësi, domethënë, shfrytëzimi i reaksioneve kimike dhe prodhimi i bar-nave; purgativ e lehtë dhe jakia me gjatan etj. Kishte dëshirë të madhe të bënte autopsi. Edhe në këtë degë të diturisë zbuloi shumë gjëra. Në pleqëri u verbua dhe shkoi t'i operonte sytë, por, kur nuk mori përgjigje për pyetjen "Sa shtresa ka syri?", nuk i pranoi kirurgët, duke thënë "Sa kohë që nuk gjendet një kirurg që di sesa shtresa ka syri, nuk mund të pranoj operacionin". Ka shëtitur dhe ka vizituar Egjiptin, Sirinë por edhe Andaluzinë.

Pesëdhjetë vjet më vonë, në Iran doli një mjek me emrin Ali Bin Abbas, të cilin e mori nën mbrojtje dhe kujdes Aduddevla, nga dinastia e Buvejhitëve. Ky personalitet, duke vënë në dukje dhe duke shpjeguar gabimet e të metat e Hipokratit e të Galenit në mjekësi, shkroi një libër jashtëzakonisht të mirë mbi mjekësinë, prej njëzet vëllimesh. Edhe kjo vepër, duke u përkthyer në gjuhët evropiane, ndihmoi shumë në përparimin e mjekësisë te popujt e kohëve të reja.

Nga fundi i shekullit të shtatë sipas hixhretit, në Shiraz lindi Husejn Ibn Sina, i cili në Buhara studioi

mjekësinë dhe shkencat e tjera. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeç shëroi nga një sëmundje e rëndë Emir Nuhin, një nga qeveritarët e qytetit. Kështu ai fitoi emër tek mbretërit sasanidë. Por, meqë nuk deshi t'i përgjigjej thirrjes së sulltan Mahmud Gazneviut, i cili, për ta marrë pranë vetes i premtoi shumë gjëra, u dënuar. Pas një kohe, nga qyteti Rej, ku ndodhej nën mbikëqyrjen e Mexhididdevles, shkoi në Hamedan dhe atje u bë kryemjek e sadrazem (kryeministër) i Shemsuddevles që ishte qeveritar i atij vendi. Ndonëse merrej me çështjet politike dhe shoqërore, Ibn Sinai punonte edhe në këtë fushë. Shkroi shumë vepra përmjet mjekësinë dhe degë të tjera të shkencës. Libri i tij me titullin *Kânûn*, i cili përbën shpjegime të hollësishme shkencore, u bë doracak në të gjitha viset e vendit përmjet gjashtë shekuj. Libri u përkthye dhe u botua në gjuhët evropiane disa herë. Në shkollat e mjekësisë të Francës e të Italisë, ndërkaq, qe vepër themelore.

24

Në shekullin e gjashtë dhe të shtatë të hixhretit, në Andaluzi kishte shumë mjekë të famshëm, si: Ebu-l-Kasim bin Abbasi, Ebu Mervan bin Abdu-l-Melik bin Zuhejri, Ebu-l-Velid Muhammed Ibni-r-Ruzhdi, Abdullah bin Ahmed bin Ali el-Betari etj.

Ebu-l-Kasimi ka qenë kirurg. Në këtë fushë ka bërë mjaft zbulime. La një vepër mbi llojet e veglave të operimit dhe përmjet mënyrën e përdorimit të tyre. Me-

todat që i zbuloi për nxjerrjen e gurit nga fshika e urinës, si dhe vendin që e caktoi për prerje, janë në përdorim edhe sot nga kirurgët evropianë.

Ibn Zuhejri lindi në Andaluzi. Pasi mësoi atje, u bë kryemjek i Jusuf bin Tasifiut, qeveritar i lartë i Persisë. Ky dijetar kundërshtoi rregullat e paraardhësve të tij. Ai i lidhte degët e mjekësisë, kirurgjisë dhe farmacisë, për të cilat kishte njohuri të plota. Zbuloi rishtazi shumë barna dhe përdorimin e tyre në mjekësi, dinte t'i shëronte dhe t'i diagnostikonte sëmundjet nga pezmatimi i organeve të ndryshme të trupit. Në fushë të kirurgjisë ka pasur mjaft njohuri për thyerjet, krisjet dhe për operacione të fytit. Edhe i biri ndoqi rrugën e t'et, e pas vdekjes së babait, u bë mjeku i Jusuf ibn Tasifiut.

Edhe Ibn Ruzhdi ka qenë një nga nxënësit e Zuhejrit, ka shkruar shumë vepra lidhur me filozofinë, misticizmin dhe me shkenca të tjera. Ka shkruar dhe një koment të hollësishëm për veprat e Aristotelit. Në fushën e mjekësisë, ndërkaq, ai ka shkruar një koment mbi veprën *Kânûn* të Ibni Sinasë dhe nga një libër për sëmundjen e etheve, sëmundjet veneriane dhe mendore.

Ibn Bitari lindi në rrëthninë e Malagës. Pasi kreu studimet në Andaluzi, shkoi për në Lindje. Atje e nderuan dhe e priten shumë mirë: në Egjipt e priti Salahuiddin Ejjubi, kurse në Siri el-Meliku-l-Adili. Shkroi një libër me titullin *el-Edvijetu-l-besîta* "Barnat e thjeshta", në të cilin jepte shpjegime të hollësishme për shtazët, bimët, drurët dhe lëndët e tjera që përdoren në mjekësi. Duke përfshirë në këtë libër edhe shumë njohuri të reja, u bënë korrigjime edhe të mendimeve të Galenit dhe Dioskordit.

Përveç këtyre, ka pasur edhe shumë e shumë mje-kë të tjera të islamë, me emrat e të cilëve, vetëm po t'i përmendim do të mbusheshin vëllime të tëra. Më të dëgjuarit megjithatë janë: Ebu Xhafer Ahmed bin Mu-hamed et-Talibi, i cili shkroi një libër, ku trajton holësisht pezmatimin e cipës së mushkërisë së bardhë dhe disa sëmundje të tjera, pastaj Thebit ibn Kurre, që është përmendur më parë, Ebu Hasan Ibn Telmidi, Ali bin Ridvani, Abdurrezaku, Hijbetullahu, Is-hak bin Ibrahimini e të tjera.

Filozofia

25

Edhe filozofia, si të gjitha shkencat e tjera, ka përparuar shumë në Botën Islame. Kur u përkthyen në gjuhën arabe veprat shkencore të grekëve në fillim të kalifatit të abasidëve, mendimet dhe mësimet e filozofëve grekë që përfshiheshin në ata libra, nuk qenë zhvlerësuar por përkundrazi, atyre u bëheshin komente e shpjegime plotësuese. Sokrati, Pitagora, Aristoteli, Diogjeni dhe autorë të tjerë patën fituar emër në botën islame. Edhe idetë e mësimet e të gjithë këtyre dijetarëve qenë bërë të njoitura.

Evropianët, duke pasur mendime të prapambetura e të errëta për Kuranin e Madhërueshëm për një kohë të gjatë nuk e pranuan filozofinë islame, por, kur i shfletuan veprat filozofike të myslimanëve dhe kur panë aty përparimet e mëdha të tyre në këtë fushë të dijes; kur panë se Kurani Kerim, që është një filozofi më vete, nuk e ndalon filozofinë, por përkundrazi, e urdhëron dhe e këshillon atë në çdo faqe të tij, e kuptuan dhe më në fund e pranuan të vërtetën.

Myslimanët nuk u mjaftuan vetëm me veprat e filozofëve grekë, por edhe i zgjeruan. Duke i shpjeguar e plotësuar me komente dhe shënimë të tjera idetë e filozofëve grekë, shkruan edhe vetë shumë libra mbi

filozofinë. Dolën filozofë të dëgjuar islamë, si: Kindiu, Muhammed bin Mesudi, Ebu Temam Nishaporiu, Ibn Sehl Belhiu, Esfrainiu, Hamiriu, Farabiu, Ibn Sina etj. Edhe filozofët e mëdhenj islamë që erdhën pas tyre, si: Ibn Baje, që është i njohur tek evropianët me emrin Avinpase, Ethirudin el-Ebheri, Ali el-Haviniu, Ibn er-Ruzhdi, Ebu-s-Salt, Nasiruddin Tusiu etj., duke zgjedhur rrugën e Farabiut e të Ibn Sinasë, shkuan edhe disa hapa më tej dhe veprat e tyre të përkthyera shërbyen si manual për shumë kohë në shkollat e Evropës. Filozofët islamë nuk ngurruan të shkruanin vëllime mbi ide e çështje më të hollësishme filozofike, prandaj në bazë të këtyre mendimeve, u ndanë në shkolla e grupe të ndryshme.

26

Shkollat dhe përhapja e filozofisë në botën islame kanë ndikuar në ndarjen e filozofëve islamë në natyralistë, materialistë, sizmatikë, mistikë, dialektikë etj., dhe, duke ndërthurur filozofinë me besimin dhe porositë fetare, lindën dituritë e akaidit, ilmu-l-kelamit e të misticizmit (tesavvufit).

Ndër dijetarët islamë që shkruan mbi filozofinë fetare, është imam Gazaliu, i cili ka shkruar afro një-qind libra të mëdhenj. Duke e mbrojtur dhe duke e madhëruar gjithnjë filozofinë islame, u bë i njohur me emrin *Huxhxhetu-l-Islam*. Ai shkroi një libër në të cilin përmblodhi vërejtjet e veta ndaj filozofëve. Sado që

shprehet kundër filozofëve, libri nuk prek e nuk nënçmon idetë e mendimet e tyre. Mendimet e disave nuk përputhen me mendimet e disa të tjerëve, por, megjithatë, shpjegojnë shkakun që sjell kundërshtimet e mendimeve të njëri-tjetrit.

Në filozofi të misticizmit, edhe te popujt islamë ka pasur emra të dëgjuar, si: Muhjidin Arabiu, Xhunejdi Bagdadiu, Shibliu, Mevlana Xhelauddin Rumi etj., të cilët kanë provuar të zbërthejnë kuptimet e fshehta filozofike të Kurani Kerimit dhe të Hadithi Sherifit dhe, duke arritur të shpinin më përpara edhe këtë pjesë të filozofisë, patën sukses të zbulonin shumë të fshehta. Te filozofët, për shembull, te Spinoza dhe tek Hegeli, të njohur në Evropë si filozofë mistikë, mund të shihet një imitim dhe një ndjekje e rru-gës së sufistëve islamë.

Edhe në ilmu-l-Kelam e në akaid, por edhe në shkencën mbi komentimin e Kur'anit e të hadithit (tefsir), pati dijetarë në zë, si: Fahruddin Raziu, Ali bin Umer el-Hatabiu, Imam Bejdaviu, Ebu Bekr Nasefiu, Shemseddin Isfihaniu dhe Husejn Shiraziu etj. Nga mutezilët kanë qenë: Muhammed Xhihaniu, Ebu Hadife el-Vasli, Ebu Ali el-Xhubbadiu, Ebu Husejn Abdusselami, Ebu Kasim Belhiu, Ibn Iljas, Ebu Jakub es Sihami etj. Qendrat e të gjithë këtyre kanë qenë Basra dhe Bagdadi. Përmbledhja “*Tuhfetu Ihvan es-Sifa*” shtjellon mendime të hollësishme filozofike edhe të këtyre filozofëve të përmendur më sipër. Kjo është dëshmi e fortë sesa janë përpjekur ata për ta ndarë nga filozofia fetare.

Ligji

27

Sikurse Kurani Kerim që ka mendime e gjykime të shumta mbi sheriatin (ligjin islam), edhe hazreti Pejgamberi (Muhammedi a.s.) ka hadithe të panumërtë që flasin për mënyrën e sjelljes, mënyrën e veprimit etj. Sheriati, domethënë, ligji islam, lindi së bashku me paraqitjen e fesë islame. Afro një shekull pasi është vepruar e gjykuar me Kuran e Hadith, mbështetja kryesore kanë qenë ajetet e Kur'anit dhe hadithet e Pejgamberit a.s., dhe në rastet për të cilat nuk kishte ajete e hadithe, është vepruar duke u mbështetur në arsyen e shëndoshë, në të sjellët drejt, në drejtësi dhe në dituri. Duke e parë të nevojshëm kodifikimin e sheriatisë, imam Azam Ebu Hanife, Imam Shafiu, imam Maliku dhe imam Hambeliu e kryen menjëherë këtë detyrë të madhe e të shenjtë, që në vitet e para të shekullit të parë sipas hixhretit. Me këtë punë i bënë shërbim të jashtëzakonshëm fesë islame dhe qytetërimit islam.

Për ruajtjen e mbrojtjen e drejtësisë dhe për mirëvajtjen e punëve në çdo anë të vendit, Harun er-Reshidi zgjodhi dhe autorizoi nëpunës Ebu Jusufin, një nga nxënësit e Ebu Hanifes. Për këtë qëllim, u caktuan personalitete, njerëz të ditur e të drejtë, në të gjitha anët.

Dijetarët e shquar në medhhebin hanefi, kanë qenë: Ebu Jusufi i sipërpërmendur, Ibrahim Halebiu, Muhammd ibn Shihab ez-Zuhejriu, Hanudini dhe Ebu Abdullah Muhammedi etj., të cilët studiuan dhe u morën me çështjet e Sheriatit.

Edhe kalifët abasidë e zgjodhën këtë medhheb në shumicën e vendeve islame të Azisë, e cila në atë kohë ishte nën udhëheqjen e kalifatit të Lindjes, dhe në Egjipt u përhap medhhebi hanefi. Ata që u ndihmuani kalifëve abasidë në këtë drejtim, janë Ebu Jusufi, që u përmend më lart; në Andaluzi Jahjai, një nga nxënësit e imam Malikut, dhe në Afrikë një personalitet me emrin Sehnun. Pas tyre, më në zë kanë qenë dhe: Muhammed el-Muvazi, Muhammed Utbiu, Ebu Mervan es-Selimi, Ebu Abdullah Muhammed bin Ibraimi, Ibn Haxhibi, Ebu Muhammed Abdullah bin Ebi Zejdi, Halil ibn Is-haku, Ibn Junuz Sikiliviu, d.m.th. sicilius dhe Ebu Abdullah Muhammed bin Ali bin Umer el-Mazariu, i cili kishte lindur në qytezën e Mazarasë, në Sicili.

Pra, medhhebi maliki u përhap në Andaluzi dhe në Afrikë.

Medhhebi shafi u përhap vetëm në Egjipt, kurse medhhebi hambeli nuk arriti të përhapej në asnje vend.

Ja pra, në këtë mënyrë myslimanët e çuan ligjin islam dhe kodifikimin e tij më përpara se çdo popull tjetër. E drejta e qytetarëve të një populli është siguruar me drejtësinë e një ligji të pandryshuar dhe nuk i është dhënë e drejta asnje kryetari a qeveritari të udhëheqë sipas qejfit të tij dhe në mënyrë vetjake.

Letërsia

28

Myslimanët kanë përparuar edhe në letërsi, ashtu si dhe në fushat e tjera. Arabët, edhe para Islamit merrreshin me poezi dhe, sado që krijonin vjersha shumë të pastra (gjuhësisht) dhe të rrjedhshme, rregullat gramatikore të arabishtes nuk qenë të përbledhura, prandaj, nuk kishin një letërsi të rregulluar e të sistemuar. Kurani Kerim u shpall me një pastërti e rrjedhshmëri gjuhësore që do t'i mahniste të gjithë poetët. Ai ushtroi ndikim të thellë në thelbin e gjuhës arabe. U bë një shembull i letërsisë, si për ata që ishin me origjinë arabe, ashtu edhe për popujt e tjerë që, duke hyrë në suaza të Islamit, arabishten e mbajtën gjuhë shkencore dhe letrare. Që të kuptionin fjalën e Zotit, rregullat morfologjike, sintaksore dhe kuptimore të gjuhës arabe, kjo çështje u interesoi në radhë të parë iranianëve dhe popujve të tjerë joarabë, të cilët, për ta kuptuar më lehtë, shkruan edhe tefsire. Në tefsire jepnin edhe shënimë të tjera plotësuese. Dhe, për ta mësuar arabishten që është gjuhë e Kuranit dhe gjuhë letrare e popujve islamë, qenë të shtrënguar të përgatisnin fjalorë.

Ja pra, së bashku me paraqitjen e Islamit, në këtë mënyrë, filloi të zgjerohej e të përparonte edhe gjuha

arabe. Edhe veprat shkencore të përkthyera ndikuan në pasurimin e kësaj gjuhe me shumë terma shkencore e të diturisë, kështu që gjuha arabe fitoi famën e një gjuhe shumë të gjerë shkencore. Meqenëse rregullat e arabishtes përbajnjë imtësi të shumta, janë shkruar shumë libra mbi morfologjinë, sintaksën, leksikografinë e semantikën arabe. Për këtë dituri kanë shkruar dijetarë, si: Sibevezhi, Zamahsheriu, Farisiu, Zexhaxhi, Ibn Haxhibi etj. Në leksikografi ndërkaq janë dalluar Xhevheriu, Fejruz Abadiu, Zamahsheriu etj.

Zamahsheriu ka shkruar dy libra për gramatikën, ka shkruar dhe një tefsir të vlefshëm me titull *Keshshâf* dhe një fjalor dygjuhësor arabisht-persisht.

Xhevheriu, pasi kishte shëtitur një kohë të gjatë viset e Arabisë, kur qe kthyer në Horasan, që ishte vendlindja e tij, hartoi një fjalor të arabishtes, me titullin *Sîhhâhu-l-Luga*.

Më vonë, edhe Fejruz Abadiu mbloodi të gjitha fjalët e gjuhës arabe. Pasi i kishte shpjeguar hollësisht librin *Mukaddime* të Ebu-l-Hasan Ali ibn Sejjidit dhe fjalorin e Hasan bin Muhammedit, që përbëhej nga njëzet vëllime, nxori në dritë një vepër prej gjashtëdhjetë vëllimesh të mëdha. Vepra *Kâmûs-î Muhit*, që përdoret edhe sot e që është në tridhjetë pjesë, është një përbledhje e asaj vepre të hollësishme. Fejruz Abadiu kishte shëtitur një kohë të gjatë nëpër Arabi, me qëllim që fjalët e dyshimta t'i hetonte e t'i dëgjonte drejtpërdrejt nga goja e arabëve të shkretëtirës, të cilët e kishin gjuhën më të pastër arabe. Përveç kësaj vepre të madhe, ai ka lënë rrëth dyzet vepra të tjera. Kur dëgjuan për aftësitë e këtij dijetari të madh, Timur-hani dhe sull-

tan Bajaziti i parë, njëri nga sulltanët e mëdhenj të Perandorisë Osmane, e shpërblyen me dhurata.

Përveç përparimeve të gjuhës arabe, edhe gjuha persiane ngriti një ndërtesë të letërsisë. Edhe ajo filloi të shkruhej me shkronjat arabe dhe nga arabishtja nisi të merrte fjalët e domosdoshme. U bë gjuhë shumë e gjerë dhe e bukur. Edhe në këtë gjuhë dolën poetë të dëgjuar për dashurinë ndaj gjuhës, si: Firdusi, Tusiu, Nizamiu, Enveriu, Saadiu, Dakikiu, Rudkiu, Shejh Attari, Hafiz Shiraziu, Husrevi etj., poezitë e të cilëve vlerësohen si mrekulli.

Edhe gjuha turke filloi të huazonte fjalë nga gjuha arabe; u zgjerua dhe filloi të shkruhej me shkronja arabe. Ashtu si dijetarët persianë e turq që kanë shkruar e kanë sistemuar rregullat e gjuhës arabe, edhe dijetarët arabë kanë shkruar mjaft vepra mbi rregullat e persishtes dhe të turqishtes.

Dijetarët islamë janë përpjekur e kanë bërë shumë për pastërtinë e rrjedhshmérinë gjuhësore. Ata kanë shkruar disa libra, si: *Telhîsu-l-Miftâh*, autor i të cilit është Saadudin Taftazaniu, kurse komentatori i këtij libri është Xhelaluddin Gazneviu; *Hadîkatu-l-Belâga*, autor i të cilit është Mir Shamsuddini; *Adabu-l-Kitab*, autor Ibn Kutejbe etj.

Halil bin Ahmed, ndërkaq, ka përdorur në botën arabe metrikën dhe rimën.

Sekkaku i dhe Sujuti kanë lënë një vepër të plotë mbi pastërtinë, rrjedhshmérinë dhe natyrën e të shprehurit ëmbël, butë, njerëzishëm.

Myslimanët kanë shkruar me një gjuhë të pastër e të pasur edhe shumë tregime e anekdota mbi moralin, etikën. Nga kjo gjini letrare me karakter edukativ ka vepra të panumërtë në gjuhën arabe e persiane. Në gjuhën arabe, për shembull: *Mekamat*¹⁹ të Ebu-l-Kism Haririut dhe Hamedhaniut; *Atvâkudh-Dhehebi* "Gjerdanët" të Zamahsheriut, *Emthâl* "Anekdotat" e Llukmanit; *Kelîle ve Dimne* dhe *Elf Lejle ve Lejle* "Një mijë e një net" etj., kurse në persishte, për shembull: "Gjylistani" i Sahabiut, *Envar-i Suhejl*; *Hamse* të Nizamit etj.

Dijetarët islamë u morën me mbledhjen e krijimtarisë popullore dhe të tregimeve me karakter edukativ, të cilat përbajnë mendime filozofike që përcaktojnë moralin dhe mendimet e një populli. Në gjuhën arabe ka shumë përbledhje të tregimeve edukative, të cilat janë më të njoitura e më të vlerësuara se të gjitha tregimet e tjera.

Janë mbledhur dhe janë bërë shumë vëllime të folklorit arab. Ebu-l-Ferexh Isfihaniu, që shkroi një libër të madh me titull *Agâni Kebîr* "Thesaret e mëdha", mblodhi shumë gjëra dhe këngë popullore. Shumë prej tyre i futi në përbledhje historike e poetike, që, megjithatë, nuk do gjenin vend në histori.

¹⁹ Mekamet janë zhanër letërsisë klasike arabe që u zhvilluan në periudhën e tretë të abasidëve, në vitin 960 të erës sonë. Mekamet e marrin emrin sipas vendit ku është rrëfyer ngjarja (arab. *mekâm* "vend").

Mund të thuhet se poezia është shpikje e mysli-manëve. Sidomos rima te popujt e rinj ka kaluar nga myslimanët. Arabët për më tepër janë marrë me poezi edhe para Islamit. Në konkurset që organizoheshin rrëth Qabesë disa herë në vit, mblidheshin poetë nga të gjitha anët e Gadishullit Arabik dhe poezitë e tyre të shkruara i linin aty. Ato poezi, përmblajtjet e të cilave pëlqeheshin më së shumti, i shkruanin me shkronja të arta dhe i varnin në muret e Qabesë, kurse autorët e tyre i çmonin, i nderonin dhe i shpërblenin publikisht. Në këtë mënyrë bëhej zgjedhja e tyre. Krijimet e shtatë poetëve të varura në muret e Qabesë, u përmblodhën në një libër që quhet "Muallakatu seb'a", që do të thotë "Shtatë poezi të varura", kjo përmbledhje ruhet edhe sot e gjithë ditën. Këta shtatë poetë janë: Harith ibn Halze, Zuhejri, Amr Ibn Kulthumi, Imrul Kajsi, Tarafa, Antara dhe Lebidi.

Gjatë kohës së manifestimeve tuboheshin shumë poetë në Meke e në Medine. Hasan Ibn Thabit, Abdullah Ibn Revaha dhe Ka'b ibn Maliku arritën ta nderonin dhe të shkruanin poezi panegjirike për Hazreti Pejgamberin. Edhe Ka'bi, djali i Zuhejrit, që ishte autor i njërs nga poezitë e shtatë muallekatëve, duke u nderuar me nderim islam, shkroi *kasiden e xhybes*.

Divanet që përmbledhin poezitë e poetëve arabë, janë të panumërtë. Në shekullin tre të hixhretit (shek. 9), Ebu Temmam Habib Taji bëri një vepër të mrekullueshme me titull *Hamase* (antologji), ku përmblodhi

poezitë më të mira të poetëve arabë. Edhe Mutenebbiu shkroi një poezi me emrin *Sejfu-d-Devle* ("Shpata e shtetit").

Poetët arabë që ndërkojë gjendeshin jashtë Gadi-shullit Arabik, ndër ta edhe Ebu Huvasi, Ibn Durisi dhe Ibn Farhiu, filluan ta keqpërdorin poezinë. Duke u marrë edhe me shkencë, ata zunë të prishnin frymën realiste të poezisë dhe kështu dalngadalë poezitë burimore arabe filluan t'ia humbnin frymën dhe fuqinë shprehëse.

Poezitë arabe janë shumë të pastra gjuhësish dhe ndikuese, por shumica prej tyre nuk janë dhe pa të meta, sepse janë të pakta ato poezi që i përfundojnë temat e nisura. Kjo karakteristikë që është mangësi te shumica e poetëve arabë, plotësohet te poetët persianë. Te poetët persianë shihet një sistemim dhe një rregull shumë i madh. Ndërsa shumica e poetëve arabë shkruajnë gazele e kaside, persianët kanë epope, p.sh. *Shahnameja* e Firdusit, *Penxh-i Genç* i Nizamit. Attari dhe Xhamiu kanë shumë vepra që përbëhen nga tre-gime të ndryshme në vargje. Sido që të jetë, qoftë në këto dy gjuhë, qoftë në gjuhën turke ka shumë poezi që kanë kupime të thella.

Historia

31

Edhe në histori myslimanët kanë punuar më shumë se çdo komb tjetër. Katib Çelebiu në bibliografinë e tij *Keshfi-dh-Dhunûn fi Esâmiji-l-Kutubi ve-l-Funûn* ka përmendur një mijë e treqind historianë. Historianët islamë më në zë janë: Ebu-l-Fidai, Ebu-l-Ferexhi, Burhanudini, Ibn Haldunin dhe Makriziu, veprat e të cilëve kanë shërbyer si burime të dorës së parë për historianët evropianë.

Ebu-l-Fidai, ndonëse ishte në Siri dhe kishte marrë pjesë e kishte treguar trimëri nëpër luftëra, nga njëra anë, dhe kishte treguar drejtësi të jashtëzakonshme në qeverisje, nga ana tjetër, nuk e kalonte kohën kot, por gjithnjë merrej edhe me shkencë. Siç kemi bërë të ditur më lart, ai shkroi një libër të plotë gjeografie. Ebu-l-Fidai shkroi edhe një vepër të plotë historie, që përmban njohuri të mjaftueshme për të gjithë popujt, me theks të veçantë për popujt islamë dhe për Perandorinë Bizantine.

Në fillim Ebu-l-Ferexhi ka qenë peshkop në Halep. Ai shkroi një vepër në gjuhën siriane, ku shtjellonte historinë e të gjithë popujve, sidomos të arabeve e të mongolëve, si dhe për pushtimet e Xhingis-

Hanit. Pasi u përgëzua me nderim islam, këtë vepër e përktheu vetë në gjuhën arabe.

Ndonëse Burhanudini në fillim punonte në medresenë *Nexhmu-l-Mulk* të Bagdadit dhe më pastaj, si arsimtar në Mosul, në medresenë që e themeloi Kadi Kemaluddin Shehr-i Zuriu, u tërroq në Egjipt nga Salahuddin Ejjubi dhe u caktua arkeolog. Pas vdekjes së të lartpërmendurit, nga ana e fëmijëve të tij u caktua arkeolog në kadillëkun e Halepit, aty themeloi një shkollë fillore (mektep) dhe një medrese. Pas një kohe, me vetëdëshirë, u tërroq krejtësisht nga detyra e nëpunësit dhe filloi të merrej vetëm me studime e kërkime. La pas vetes një vepër të plotë historike.

Ibn Halduni shkroi një vepër të rëndësishme historike për arabët, berberët dhe popujt e tjera. Ky personalitet është i njojur dhe për faktin se gjithnjë dëshironte ta thoshte të vërtetën dhe nuk i pëlqente t'i zmadhonte e t'i lëvdonte gjërat. Vepra historike e tij ka hyrjen prej tri vëllimesh, që bën fjalë për historinë politike, aty jepen edhe shumë njojuri për rrethanat e popujve dhe të personaliteteve. Hyrja është përkthyer edhe në gjuhën turke nga Piri-zade në kohën e sulltan Ahmedit të tretë. Ibn Halduni ka lënë një libër mbi arkitekturën, si dhe vepra të tjera.

Tekijuddin Ahmed Makriziu ka qenë bashkëkohës i Ibn Haldunit. La dy vepra të rëndësishme që përbajnë shumë njojuri mbi historinë, gjeografinë, qeverisjen dhe fusha të tjera: njëra, që kur ra Egjipti nën memlukët, tjetra, Egjipti në duart e myslimanëve. Ka shkruar dhe një vepër për monedhat islame. Për t'i përfshirë sipas rendit alfabetik emrat e princërvës dhe

të njerëzve të mëdhenj që banonin në Egjipt ose që e vizitonin atë, dijetarët dhe emra të tjerë të dëgjuar, ai nisi të shkruante një bibliografi në afro tridhjetë vëllime, por vdiq dhe nuk arriti ta përfundonte këtë vepër të madhe. Një vëllim i papërfunduar, i shkruar me dorën e autorit, ndodhet në bibliotekën e Parisit.

Për historinë e Egjiptit kanë shkruar edhe: Xhemaluddin Ibn Vasli, Ebu-l-Mehasin Bedriu, Ibn Ijas, Shemsuddin Ibn Ebi-s-Sururi, po edhe Sujutiu. Suju-tiu ishte nga qyteti Seput i Egjiptit. Ka shkruar aq libra, saqë njeriu nuk do të mund t'i lexonte gjatë një jete të tërë. Nga dijetarët e Bagdadit, Abdulatifi, që ishte bashkëkohës i Salahuddin Ejjubit, ka shkruar një libër të plotë, në të cilin njoftonte hollësisht për ngjarjet e Egjiptit. Kjo vepër u përkthye në gjuhët evropiane dhe gjeti përhapje shumë të madhe.

Taberiu lindi në Taberistan në shekullin e katërt të hixhretit. Pasi studioi në Bagdad, ndonëse u mor kryesisht me shkencat e shariatit, shkroi hollësisht një histori të përgjithshme. Më vonë atë e përmblodhi vetë.

Një shekull më vonë doli Mesudi. Meqenëse u bë i njobur në një varg disiplinash shkencore, shkroi dy libra në më shumë se njëzet vëllime: *Ahbâru-z-Zemân* "Lajmet e kohës" dhe *el-Kitâbu-l-Evsat* "Libri i lindjes së Mesme". Këta libra jepnin njoburi shumë të gjera, por, për fat të keq, disa gjëra aty janë si të pavërtetura. Mesudi ka lënë edhe një vepër me titullin *Murâdu-dh-Dhehebi ve-l-Medinu-l-Xhevâhiri*.

Ibn Ethiri, pasi studioi në Bagdad, u tërhoq në Mosul dhe atje shkroi librin *Kemâlu-t-Tevârihi* "Plotë-

simi i historive". Ebu Talib Aliu kësaj historie i shtoi ngjarjet për tridhjetë vjetët e mëpastajmë dhe Mevlana Nexhmedin Nedhariu e përktheu në gjuhën persiane. Përveç kësaj, Ibn Ethiri shkroi edhe disa vepra të tjera historike.

Nuvejri ka qenë nga historianët e Egjiptit. Në veprën e tij prej tridhjetë vëllimesh, jep njohuri të hollësishme mbi rrethanat dhe ngjarjet e lashta të arabëve para Islamit. Pas Nuvejrit, Ibn Ferati shkroi një veprë historike në njëzet vëllime, kurse Ahmed Arabshahu shkroi një histori të plotë për Timur Hanin.

Në shekullin e shtatë të hixhretit Ibn Vasli përmblodhi veprën historike të Taberiu; Ibn Xheuziu shkroi një libër historie me titull *Mer'etu-z-Zemân* etj., në shekullin e pestë, ndërkaq, Utbiu shkroi historinë e Sulltan Mahmud Gazneviut; Ibn Kutejbe shkroi një libër mbi biografitë e poetëve arabë etj.

Në Andaluzi pati shumë historianë. Ashtu siç botuan shumë vepra historike të veçanta për Azinë dhe Magrebin, po ashtu i bënë shërbime të mëdha edhe historisë së përgjithshme.

Në shekullin e tretë, Ibni Kutejbe shkroi një vepër të plotë mbi mënyrën e marrjes së Andaluzisë nga ana e myslimanëve. Po në atë shekull, edhe Ahmed ibn Muhammedi botoi një vepër të rëndësishme e të plotë mbi përpjekjet kulturore të poetëve të njohur e të kalifëve të parë në Andaluzi, si dhe mbi shtetin e Andaluzisë. Nga historianët e shekullit të pestë sipas hixhretit, Ibn Farati mblodhi dhe regjistroi biografitë e poetëve dhe dijetarëve islamë. Ibn Hatibi, i cili jetoi e veproi në Granadë në shekullin e tretë të hixhretit, shkroi

një vepër të plotë historike, duke dhënë shumë njohuri të paregjistruara mbi rrethanat historike të Andaluzisë dhe të Afrikës. Veprat e shtë përkthyer në gjuhët evropiane, kurse historiani Mekarri, i cili fitoi aq emër, nga kjo vepër e Ibn Hatibit ka marrë shumicën e njohurive historike. Përveç një vepre të plotë mbi historinë e Andaluzisë, Mekarri ka lënë edhe veprat *Sîru-n-Nebij* "Biografia e Pejgamberit" dhe një koment mbi Mukaddimen historike të Ibn Haldunit. Edhe Kajsiu, një nga dijetarët e Andaluzisë, në shekullin e gjashtë shkroi biografinë e poetëve dhe dijetarëve islamë të shekullit të pestë, radhitur sipas alfabetit.

Ibn Hajjami ka shkruar një histori të përgjithshme të Spanjës, kurse Ibn Subejhu, në shekullin e shtatë shkroi historinë e ardhjes dhe qëndrimit të murabitëve dhe të muvehidinëve në Andaluzi. Ibn Harithu-l-Hasaniu ka shkruar një vepër të plotë për historinë e kadijve, kurse Shehabuddin Ahmed el-Fasiu, një vepër të rëndësishme të historisë së përgjithshme. Këtë vepër historie më vonë e ka përbledhur el-Haxh Shetiliu.

Meqenëse vetëm me emrat e historianëve islamë dhe me titujt e veprave të tyre do të mund të mbushnim shumë vëllime të mëdha, dhe pasi përmendëm historianët më të njohur arabë, do të mjaf-tohami të përmendim disa personalitete nga historianët më në zë, që kanë shkruar në gjuhën persiane.

Në kohën e sulltanatit të Ebu-l-Gazi Husejnит nga fisi Timur, d.m.th., në shekullin e nëntë të hixhretit (shek. 15), Hemamuddin Mirhondi i cili ishte nën kujdesin e Ali Shirit të njohur, vezirit të mbretit të lart-

përmendur kishte shkruar një histori të përgjithshme, ku trajtonte ngjarjet deri në kohën e sulltanatit të Shahruhut. Në këtë histori janë përfshirë shumë njoħuri mbi Lindjen. Djali i historianit të përmendur më sipër, Hundemiri, përveç që e shkurtoi historinë e t'et, la një vepér shumë të vlefshme me titull *Habību-s-Sîr*, në të cilën përshkruhen ngjarjet e viteve të fundit të shekullit të nëntë dhe viteve të para të shekullit të dhjetë sipas hixhretit (shek. 16), domethënë përfshin edhe periudhën që nga vdekja e babait të tij. Në këtë vepér janë paraqitur edhe dokumentet zyrtare (fermane, sixhile etj.), që kanë qenë të njoħura dhe janë përdorur në botën islame deri në vitet e para të shekullit të tetë, sipas hixhretit. Reshiduddini, historian i njoħur, ka shkruar një libér mbi mongolët, kurse Sherifuddin Aliu, pér Timurlengun. Devlet Shahu, ndérkaq, ka lënë një vepér biografike pér poetët.

32

Dijetarët islamë janë themelues të gjeografisë, historisë dhe biografive me rend alfabetik. Ky lloj vep-rash në Evropë pikërisht tanimbahet nga më të dobishmit. Veprat pér këto shkenca në gjuhën arabe janë të panumërt. Ashtu siç ka shumë libra të tillë enciklopedikë, historikë e gjeografikë, si p.sh. me zëra pér qytetet, shtetet, malet, lumenjtë, ngjarjet, personalitet etj., p.sh. në veprën *Mu'xhemu-l-Buldân* të Jakut Hemeviut dhe Ubejtu-l-Bekriut, po ashtu ka shumë

vepra të këtij lloji me emrat dhe biografitë e personaliteteve të dëgjuara, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë shkencor. Ka shumë e shumë vepra historie, disa prej tyre i kemi përmendur më sipër; ja edhe disa të tjera: *Kutuphane-i Hukemâ* e Zavzeniut; *Tabakâtu-l-Etibbâ* e Ibn Ezibes dhe Ahmed bin Kasimit; *Vefajâtu-l-A'jân* e Ibn Halikanit; *Tabakâtu-l-Udebâ* e Jakut Hameviut; *Tabekâtu-n-Nuha* e Sujutiut etj.

Libri *Keshfu-dh-Dhunûn fi Esâmiyi-l-Funûn* e Katib Çelebiut, një nga dijetarët e kohës së sulltan Muratit të katërt, lexohet me kënaqësi të veçantë. Kjo vepër madhështore e tij përfshin tetëmbëdhjetë mijë e pesë-qind emra të autorëve me biografitë dhe bibliografitë e tyre.

Mjeshtëritë dhe zbulimet gjeografike

33

Feja islame e ndalon dhe e përbuzë përtacinë. Myslimanët janë përpjekur, kanë punuar, sepse kanë qenë të shtrënguar dhe janë urdhëruar të punojnë. Për më tepër tokat e myslimanëve në Azi, në Afrikë dhe Evropë janë më të mirat dhe më prodhueset. Këto vende që nga luftërat e romakëve dhe të popujve të tjerë të mëparshëm, ishin kthyer në gërmadha, kurse më vonë me përpjekjen, mundin dhe me dijen e njo-huritë islame, për një kohë të shkurtër u bënë lulishtja e botës. Myslimanët dhanë me shumicë çdo lloj të prodhimeve kudo: në Andaluzi, në Magreb, në Afrikë, në Egjipt, në Siri, në Irak, në Persi, në Horasan, në Brahmaputra dhe në vende të tjera islame. Ata nxorën dhe përpunuani mineralet; i çuan përpara të gjitha artizanatet. Në të gjitha viset e shteteve islame u hapën rrugë e u ndërtuan puse, çezma, pishina uji, karvan-saraje, si dhe vepra të tjera shërbimesh e mbrojtjeje. Përparoi shumë edhe lundrimi. Në saje të busullës së shpikur prej tyre, myslimanët arritën të shëtisnin e të pushtonin detet e oqeanet. Prodhimet bujqësore dhe artizanale të myslimanëve shpërndaheshin nëpër vendet e tjera të botës përmes tregtarëve. U lidhën marrë-dhënie tregtare me Indinë, Kinën e Zanzibarin. Këto

vende të largëta dhe pikat, si: Adeni, Basra, Kabuli etj., u shndërruan në qendra tregtare dhe karvanet detyroheshin gjithnjë të kishin marrëdhënie të vazhdueshme me shtetet islame, nga Lindja e deri në Perëndim. Përparimi në kimi: përgatitja e ngjyrave, nxjerja e mineraleve; përparimi i mekanikës, shpikja e veglave për zejet e bujqësisë – bënë që të kishte më shumë përfitime nga toka. Marrja me zeje e me tregti nuk është një punë e papëlqyeshme, siç është te disa popuj dembelë, përkundrazi, është shumë e lavdëruar dhe e pranuar. Pasuria arriti në shkallën më të lartë ngado në Shtetin Islam. Ato pasuri të shumta lindën dëshirën për zbukurim në veshmbathje, në shtroje, në ndërtimë dhe në çdo gjë tjeter. Edhe njohuritë e marra në një mjeshtëri ndihmuan në rrjedhën e këtyre dëshirave. Duke u krijuar një hijeshi e jashtëzakonshme në zeje e ndërtim, u punuan shumë stofra të bukura me vizatime artistike, thurje me gjilpërë e me këmbëza dhe u goditën sarajet *el-Hamra* dhe *el-Kasr* (në Spanjë – M.P.), që janë dëshmitare të gjalla të qytetërimit islam. U ndërtuan edhe xhami, saraje dhe godina të tjera të mrekullueshme.

Megjithëse në skulpturë myslimanët nuk kanë vepra si ato të grekëve, është në zë zotësia e tyre në vizatimin dhe gdhendjen e luleve të bukura e të shkrimeve artistike, të cilat evropianët i quajnë me një emër “arabeska”, d.m.th. “gjëra karakteristike për arabët”. Shkencën e arkitekturës romakët e kanë shpëtuar me shumë vështirësi nga ndikimi i tyre. Arritja e saj në gjendjen e tanishme, sidomos ndërtimi i qemerit dhe kubesë, është shpikje e myslimanëve.

Meqenëse pasuria dhe mirëqenia ndikojnë në rritjen e popullsisë, shumë qytete të vendeve islame, që tani nuk kanë më shumë se 40-50.000 banorë, asokohe kishin rrëth një milion banorë. Shumë rajone që tani janë kthyer në gërmadha, atëherë kanë qenë qendra tregtare shumë të pasura, dhe shumë krahina që tani janë shkretëtira të thata, atëherë kanë qenë të pasura, si një kopsht i bukur.

Muslimanët e Spanjës dhe të Magrebit mbanin në duart e tyre tregtinë e Detit Mesdhe. Limanet e këtij deti ishin plot me anije dhe shumë herë kalonin në oqeanin Atlantik nëpër ngushticën e Gjibraltarit. Për pak do ta kishin zbuluar Amerikën, por nuk besonin se gjysma e botës është e zbrazët. Ndonëse e kuptuan se toka e panojohur duhej të ishte në Oqeanin Paqësor dhe ndonëse u përpoqën disa herë të mos ktheheshin, fatkeqësisht, shtërngatat e mëdha i detyran të ktheheshin prapa, duke ia lënë këtë nder e lavdi Kristofor Kolombit.

Muslimanët e Lindjes, ndërkaq nëpër Gjirin e Basrës dhe Babu-l-Mundebit zbritën në detin Oman dhe në Oqeanin Paqësor e të Indisë. Përmes tregtisë, sikurse veprojnë sot anglezët, futën në dorë bregun lindor të Afrikës, deri në Gjirin e Shpresës (Umid Burnu) dhe ndikuani që shumica e popullatës të pranonin fënë islame dhe gjuhën arabe. Në shumë ujdhesa të bregdetit të Indisë e Kinës dhe të Oqeanit Paqësor bënë për vete qendra të posaçme tregtie. Edhe atje muslimanët dalngadalë u bënë me miliona dhe zëvendësuan malajasit dhe hushitët, banorë të ujdhesave të oqeanit Paqësor. U bënë ndërmjetës të përhapjes së fesë islame deri në Borneo.

Ndërsa evropianët kishin shumë probleme e vështirësi për të shkuar në Kinë, myslimanët depërtuan atje nga anët veriore dhe perëndimore, përmes rrugës tokësore. Përmes kësaj rruge dërguan veprat e qytetërimit islam deri në Pekin. Edhe përmes rrugës detare arritën deri në qytetin Kanton, në lindje të Kinës, madje atje bënë që shumë e shumë gjëra të kallonin në duart e tyre. Kështu, pushteti kinez qe i detyruar të zgjidhte një kadi nga radhët e vetë myslimanëve, i cili do të lejonte dhe do të ndihmonte në gjykimet në gjykatat atje.

Nga brigjet veriore e lindore të Afrikës, myslimanët depërtuan deri në viset e zezakëve, në brendi të këtij vendi, që evropianët akoma nuk kishin mundur t'i zbulonin. Ata shkuan atje me qëllim tregtie, nga njëra anë, dhe për t'i shpëtuar edhe zezakët nga gjendja e egërsisë, nga ana tjetër. Kështu, edhe zezakët i futën në kornizat e qytetërimit islam.

Disa zbulime

34

Tanimë nuk dyshohet se zbulimi i letrës, i barutit dhe i busullës është bërë nga myslimanët, zbulime të cilat disa historianë gabimisht ua veshin kinezëve. Që nga fillimi i shekullit të shtatë, letra përpunohej nga mëndafshi në Samarkandë e Buhara. Në fillim të shekullit të dytë letra zuri të përpunohej prej liri në Damask. Kjo përmendet në librat e autorëve grekë të Konstatinopojës. Meqenëse në Andaluzi prodhohej shumë pambuk, letra përpunohej nga pëlhirat e pambukut dhe eksportohej në Francë, Itali, Angli e Gjermani.

Edhe baruti përdorej nga myslimanët që nga shekulli i parë i hixhretit. Në shumë histori të shkruara në atë kohë përmendet se në rrëthimin e Mekës, në luftërat e zhvilluara në Egjipt, në Tunis dhe në Granadë, janë hedhë predha me anë të barutit, me krisma të mëdha.

Dihet se busulla është përdorur jo vetëm në dete, por edhe në tokë, për të përcaktuar drejtimin e Kibles në Mekkë. Është përdorur edhe në karvane. Pra, nuk qëndron fare që këto tri gjera t'i kenë përdorur kinezët të parët.

Përfundim

35

Zbulimet në dituri e në shkencë dhe përparimet në mjeshtëri e në tregti, që i kemi përmendur në këtë broshurë, mjaftojnë të dëshmohet e të vërtetohet se në ç'shkallë ka qenë ky qytetërim. Shkakun dhe mënyrën e shturjes e të ngecjes së popujve islamë, si janë katusur në këtë gjendje tash, do të pëpiqem ta shpjegoj në broshurën e serisë *Cep Küütüphanesi* ("Biblioteka e xhepit"), që do ta shkruaj me titullin *Umem İslamiyenin Mâzi ve Hâl ve Istikbâli* "Popujt islamë, e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja", dhe në broshurën tjeter të titulluar *Uruba Medeniyyeti* "Qytetërimi evropian", në të cilën do të shkruajmë se qytetërimi i tanishëm evropian ka lindur nga qytetërimi islam.²⁰

²⁰ Këto dy vepra Samiu nuk arriti t'i botonte. Deri më tash nuk janë gjetur madje as dorëshkrimet e tyre.

110 [Q Y T E T E R I M I I S L A M]



Copyright©Logos-A, 2009

www.logos-a.com.mk



Eshtë shkruar sa e sa herë se Sami Frashëri, ky dijetar i madh shqiptar, i njohur në shkallë ndërkontinentare, shkroi shumë vepra (mbi gjashtëdhjetë) në shumë fusha e në shumë gjuhë: shqip, turqisht, arabisht, persisht, frëngjisht, greqisht etj.

Sipas një llogaritjeje duke u mbështetur në monografitë e shkruara për të, (disa vepra kryesore të tij i kemi edhe ne) del se Samiu ka shkruar rreth 20 mijë faqe, duke mos i llogaritur këtu disa vepra të pabotuara dhe artikujt e shumtë të botuar nëpër gazeta e revista të ndryshme të kohës.

Eshtë kjo vepra e parë e plotë, e tërësisht me përbajtësore në gjuhën shqipe për qytetërimin islam. I mbrujtur me kulturën e gjërë të qytetërimit islam, nga njëra anë, dhe të qytetërimeve të tjera, nga ana tjetër, Samiu në këtë vepër shtron shumë çështje interesante.

Për Samiun thelbi i qytetërimit dhe masa e zhvillimit të tij është dituria. Për të arritur një shkallë të lartë të qytetërimit, sipas tij, njeriu duhet ta vëre në shërbim mendjen, të përpinqet vazhdimesh të punojë, të mësojë e të zbulojë të vërtetën dhe gjëra të reja të dobishme, të cilat do t'i mundësojnë e do t'i sigurojnë mirëqenien e tij dhe të njerëzimit në përgjithësi.

Pas këtyre përgjithësimeve, Samiu hyn në thelbin e problemit. Me frymë polemizuese u përgjigjet shumë pyetjeve që qarkullonin në kohën e tij: Ç'është qytetërimi islam, frysht dhe rezultat i çkaje është? A mund të quhet "qytetërimi islam" "qytetërim arab"? Si dhe sa ka ndikuar qytetërimi islam në qytetërimin evropian, përkatësisht, sa e ka ndihmuar qytetërimi islam qytetërimin evropian? A është i kufizuar qytetërimi islam vetëm tek një popull a tek një bashkësi? Në ç'mënyrë u përhap qytetërimi islam? Kush e ka ndihmuar përhapjen e qytetërimit islam dhe ku e ka mbështetjen ai? etj. Të gjitha këtyre pyetjeve dhe shumë të tjera, që nuk i përmendëm këtu, Samiu u përgjigjet qartë dhe në mënyrë të argumentuar.

